



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 14

21 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 77, datë 30.1.2013	Për miratimin e “Rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik” 433
Vendim i KM nr. 86, datë 30.1.2013	Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit, certifikimit dhe testimit të varieteteve për farat e drithërave..... 447
Vendim i KM nr. 87, datë 30.1.2013	Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit, certifikimit dhe testimit të farave foragjere..... 473

VENDIM
Nr. 77, datë 30.1.2013

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLIT TEKNIK PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË INSTRUMENTEVE TË PESHIMIT JOAUTOMATIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore” dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit e Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve të peshimit joautomatik”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.¹

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
**PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË INSTRUMENTEVE
TË PESHIMIT JOAUTOMATIK**

1. Qëllimi, vendosja në treg dhe lëvizja e lirë

1.1 Ky rregull teknik zbatohet për të gjitha instrumentet e peshimit joautomatik që më poshtë emërtohen “peshore”.

1.2 Për qëllime të këtij rregulli teknik, kategoritë e përdorura të peshoreve klasifikohen për:

- a) përcaktimin e masës për transaksione tregtare;
- b) përcaktimin e masës për llogaritjen e taksës doganore, tarifës, taksës, bonusit, gjobës, shpërblimit, dëmshpërblimit ose për lloje të tjera pagesash;
- c) përcaktimin e masës për zbatimin e ligjeve ose rregullave ose, për aktvlerësimin e ekspertit të dhënë në gjyq;
- d) përcaktimin e masës në praktikën e mjekimit për peshimin e të sëmurit me qëllim monitorimin, diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor;
- e) përcaktimin e masës për përgatitjen e ilaçeve sipas recetës në farmaci, si dhe përcaktimin e masës në analizat që kryhen në laboratorët mjekësorë dhe farmaceutikë;
- f) përcaktimin e vlerës mbi bazën e masës për qëllimin e shitjes së drejtpërdrejtë ndaj publikut dhe të përgatitjes së para paketimeve;
- g) të gjitha zbatimet e tjera përveç atyre që jepen në pikën 1.2 a.

1.3 Për qëllimet e këtij rregulli teknik, zbatohen përcaktimet e mëposhtme:

¹ Ky akt nënligjor është përafuar plotësisht me direktivën 2009/23/ EEC e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009 për instrumentet e peshimit joautomatik. Numri Celex: 32009L0023, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian, seria L, nr. 122, datë 6 maj 2009, faqe 6-26 (OJ L 122, 16 May 2009, p. 6-26)



a) “Instrument peshues” është një instrument matës që shërben për të përcaktuar masën e një trupi duke përdorur veprimin e gravitetit në atë trup. Instrumenti peshues mund të shërbejë gjithashtu për të përcaktuar madhësi të tjera që lidhen me masën, si: sasi të, parametrat ose karakteristikat.

b) “Instrumenti peshues joautomatik” ose “peshore” është një instrument peshues që kërkon ndërhyrjen e operatorit gjatë peshimit.

1.4 Vendosen në treg vetëm peshoret që plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

1.5 Peshoret për përdorimet e referuara në pikën 1.2, nuk vendosen në shërbim përdorim ato të plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik dhe në të njëjtën kohë të kenë markimin CE të konformitetit si të përcaktuar në pikën 3.

1.6 Peshoret e përdorura për zbatimet e dhëna në pikën 1.2 a, duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të dhëna në pikën 4.

Në rastet kur peshorja përfshin ose është e lidhur me pajisje, të cilat nuk përdoren për zbatimet e dhëna në pikën 1.2 a, këto pajisje nuk janë subjekt i kërkesave thelbësore.

1.7 Nuk pengohet vendosja në treg e peshoreve që plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

1.8 Nuk pengohet vendosja në shërbim e peshoreve për përdorimet e referuara në pikën 1.2 a, të cilat plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

1.9 Peshoret prezumohen se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të dhëna në pikën 4 kur ato janë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, numrat e referimit të të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare.

1.10 Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut provon se peshoret që mbajnë markimin CE të konformitetit të referuar në pikat 7.2, 7.3, dhe 7.4, kur instalohen dhe përdoren sipas qëllimit për të cilin ato janë prodhuar, nuk plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik, merr masat e parashikuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, për tërheqjen e këtyre peshoreve nga tregu, ndalimin apo kufizimin e vendosjes së tyre në treg.

2. Vlerësimi i konformitetit

2.1 Përputhshmëria e peshoreve me kërkesat thelbësore të dhëna në pikën 4 të këtij rregulli teknik mund të certifikohet me një rën nga procedurat e mëposhtme, sipas zgjedhjes së aplikantit:

a) Shqyrtimi EC i tipit, siç jepet në pikën 5.1 dhe që shoqërohet nga deklarata EC e konformitetit të tipit (sigurimi i cilësisë së prodhimit), siç jepet në pikën 5.3. Megjithatë, shqyrtimi EC i tipit nuk është i detyrueshëm për peshoret që nuk përdorin pajisje elektronike, si dhe për ato peshore, të cilat nuk përdorin sustë për të balancuar peshën.

b) Verifikimi EC i njësisë siç jepet në pikën 5.1.

2.2 Dokumentet dhe korrespondenca e lidhur me procedurat e dhëna në pikën 2.1 hartohen në shqip ose në një nga gjuhët e pranuar nga organi i autorizuar/organizëm i regjistruar evropian për kryerjen e vlerësimit të konformitetit (më poshtë emërtohet organ i autorizuar/organizëm evropian).

2.3 Kur peshoret janë subjekt dhe i rregullave të tjera teknike që mbulojnë aspekte të tjera, të cilat gjithashtu parashikojnë vendosjen e markimit CE të konformitetit, ky markim tregon se në këtë rast peshoret në fjalë konsiderohen në përputhshmëri me dispozitat e atyre rregullave teknike.

Sidoqoftë, kur një ose më shumë nga rregullat teknike që zbatohen në peshoret, i lejojnë fabrikuesit gjatë një periudhe tranzitore, të zgjedhë se cilat rregullime të zbatojë, markimi CE i konformitetit tregon përputhshmërinë vetëm me rregullat teknike të zbatuara nga fabrikuesi.

2.4 Ministria përgjegjëse për ekonominë publikon në faqen zyrtare të saj degët e organizmave evropianë të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për kryerjen e procedurave të vlerësimit të konformitetit, të dhëna në pikën 2, së bashku me detyrat specifike që duhet të kryejnë dhe për të cilat janë miratuar, si dhe shoqëruar nga numri i identifikimit”.

3. Markimi CE i konformitetit dhe mbishkrimet

3.1 Markimi CE i konformitetit dhe të dhënat plotësuese të kërkuara siç përshkruhen në pikën 7.1, vendosen në mënyrë të qartë, të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqshme në peshoret për të cilët është përcaktuar konformiteti EC.

3.2 Mbishkrimet e dhëna në pikën 7, vendosen në mënyrë të qartë, të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqshme në të gjitha peshoret e tjera.

3.3 Ndalohet vendosja në peshore e markimeve, të cilat mund të çorientojnë palët e treta si për kuptueshmërinë ashtu edhe për formën e markimit “CE” të konformitetit. Çdo markim tjetër mund të vendoset te peshoret vetëm nëse nuk kufizohet dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit CE të konformitetit.

3.4 Pa paragjykuar pikën 1.10:

a) Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut konstaton se markimi CE i konformitetit është vendosur në mënyrë të padrejtë, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij është i detyruar të sjellë peshoren në përputhje me dispozitat e lidhura me markimin CE të konformitetit dhe t’i japë fund shkeljes sipas kushteve të përcaktuara.

b) Kur mospërputhja vazhdon, merr të gjitha masat përkatëse për të kufizuar ose ndaluar vendosjen në treg të peshores në fjalë ose siguron se ajo është hequr nga tregu në përputhje me procedurat e përcaktuara në pikën 1.10, si dhe masat e parashikuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.10.2011.

3.5 Kur një peshore, e cila përdoret për ndonjërin nga zbatimet e dhëna në pikën 1.2, përfshin në vetvete ose është e lidhur me pajisje, të cilat nuk kanë qenë objekt i vlerësimit të konformitetit siç jepet në pikën 2 të këtij rregulli teknik, secila nga këto pajisje duhet të mbajë një simbol, i cili kufizon përdorimin e tyre, siç përcaktohet në pikën 7.3. Ky simbol vendoset në këto pajisje në mënyrë qartësisht të dukshme dhe të paheqshme.

4. Kërkesat thelbësore

Terminologjia e përdorur është ajo e Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore, OIML.

Kur një peshore përfshin ose është e lidhur me më shumë se një pajisje printimi ose tregimi e përdorur për aplikimet e dhëna në pikën 1.2 a dhe, të cilat përsërisin rezultatet e veprimeve të peshimit dhe që nuk influencojnë në funksionimin korrekt të peshores, nuk janë subjekt i kërkesave thelbësore nëse rezultatet e peshimit printohen ose ruhen saktësisht dhe në mënyrë të paheqshme nga një pjesë e peshores, e cila plotëson kërkesat thelbësore dhe rezultatet janë të pranueshme për të dyja palët e interesuara për matjen. Megjithatë, në rastin e peshoreve që përdoren për shitje direkt në publik, pajisja e tregimit dhe e printimit duhet të plotësojë kërkesat thelbësore për klientin dhe shitësin.

Kërkesat metrologjike

4.1. Njësitë e masës

Njësitë e masës që përdoren janë njësitë, të botuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1162, datë 13.8.2008 “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”;

Subjekt i plotësisht të këtij kushti janë njësitë SI:

kilogram, mikrogram, miligram, gram, ton.

4.2. Klasat e saktësisë

4.2.1 Klasat e saktësisë janë përcaktuar si më poshtë:

- I Speciale
- II E lartë
- III Mesatare
- IIII E zakonshme

Specifikimet për këto klasa janë dhënë në tabelën 1.



TABELA 1
KLASAT E SAKTËSISË

Klasa e saktësisë	Ndarja verifikuese e shkallës e (intervali i shkallës së verifikimit)	Kapaciteti minimal min (kufiri i poshtëm)	Numri i ndarjeve verifikuese të shkallës $n = \max / e$	
			minimal	maximal
Speciale I E lartë	0.001 g □ □e	100 e	50 000	-
II E mesme	0.001 g □ □e	20 e	100	100 000
III E zakonshme	□ □ □ □ □ □ □ g	50 e	5 000	100 000
III E zakonshme	0.1 g □ □e	20 e	100	10 000
	0.1 g □ □e □ □ □ □ □ g	20 e	500	10 000
	5 g □ □e	10 e	100	1 000
	5 g □ □e			

Kapaciteti minimal zvogëlohet deri në 5e për peshoret e klasës II dhe III, të cilat përdoren për përcaktimin e tarifës në transportin e dërgesave.

4.2.2 Ndarjet e shkallës

4.2.3 Ndarja reale e shkallës (d) dhe ndarja verifikuese e shkallës (e) është në formën:

1 x 10k, 2 x 10k, ose 5 x 10k njësi të masës, ku k është një numër i plotë ose zero.

4.2.4 Për të gjitha peshoret të ndryshme nga ato me pajisje treguese ndihmëse: $d = e$

4.2.5 Për peshoret me pajisje treguese ndihmëse zbatohen kushtet e mëposhtme:

$$e = 1 \times 10k \text{ g}$$

$$d < e \leq 10 d$$

përveç peshoreve të klasës I me $d < 10^{-4}$ g, për të cilat $e = 10^{-3}$ g.

4.3 Klasifikimi

4.3.1 Peshoret me një diapazon peshimi

Peshoret e pajisura me një pajisje treguese ndihmëse i përkasin klasës I ose klasës II. Për këto dy klasa peshorësh, kufijtë e poshtëm të kapacitetit minimal merren nga tabela 1, duke zëvendësuar te kolona e tretë ndarjen verifikuese të shkallës (e) me ndarjen reale të shkallës (d).

N.q.s. $d < 10^{-4}$ g, kapaciteti maksimal i klasës I mund të jetë më i vogël se 50000 e.

4.3.2 Peshoret me shumë diapazone peshimi

Lejohen shumë diapazone peshimi, me kusht që ato të tregohen qartësisht mbi peshore. Çdo diapazon individual peshimi klasifikohet sipas nënparagrafës 4.3.1. Nëse diapazonet e peshimit u takojnë klasave të ndryshme të saktësisë, peshorja duhet të veprojë në përputhje me kërkesat më të forta që zbatohen për klasat e saktësisë në të cilën përfshihen diapazonet e peshimit.

4.3.3 Peshoret me shumë intervale

4.3.4 Peshoret me një kufi peshimi mund të kenë disa kufij të pjesshëm peshimi (peshoret me shumë intervale).

Peshoret me shumë intervale peshimi nuk janë të pajisura me pajisje treguese ndihmëse.

4.3.5 Çdo kufi i pjesshëm peshimi i peshoreve me shumë intervale përcaktohet nga:

- a) ndarja verifikuese e shkallës së tij, e_i me $e_{(i+1)} > e_i$
- b) kapaciteti maksimal i tij, $\text{Max } i$ me $\text{Max } r = \text{Max}$
- c) kapaciteti minimal i tij, $\text{Min } i$ me $\text{Min } i = \text{Max}(i-1)$ dhe $\text{Min } 1 = \text{Min}$

ku :

$i = 1, 2, \dots, r$

i = numri i kufirit të pjesshëm të peshimit

r = numri i përgjithshëm i kufijve të pjesshëm të peshimit

Të gjitha kapacitetet janë kapacitete të ngarkesës neto, pavarësisht nga vlera e ndonjë tare të përdorur.

4.3.6 Kufijtë e pjesshëm të peshimit janë klasifikuar sipas tabelës 2. Të gjithë kufijtë e pjesshëm të peshimit, duhet të jenë brenda së njëjtës klasë saktësie; kjo klasë është klasa e saktësisë së peshores.

TABELA 2
PESHORET ME SHUMË INTERVALE

Klasa	Ndarja verifikuese e shkallës (e)	Kapaciteti minimal (min.)	Numri i ndarjeve verifikuese të shkallës	
			Vlera minimale ¹⁾ $n = \text{Maxi}/e_{(i+1)}$	Vlera maksimale $a = \text{Maxi}/e_i$
I	0.001 g □□ei	100 ei	50 000	-
II	0.001 g □□ei	20 ei	5 000	100 000
	□□□□□□□g	50 ei	5 000	100 000
III	0.1 g □□ei	20 ei	500	10 000
	0.1 g □□ei□□□□□g	10 ei	100	1 000
	5 g □□ei			

$i = 1, 2, \dots, r$

i = numri i kufirit të pjesshëm të peshimit

r = numri i përgjithshëm i kufijve të pjesshëm të peshimit

tabela 2

¹⁾ Për $i=r$ zbatohet kolona korresponduese e tabelës 1, duke zëvendësuar e me er.

4.4 Saktësia

4.4.1 Me zbatimin e procedurave të dhëna në pikën 3 të këtij rregulli teknik, gabimi i tregimit nuk e kalon gabimin më të madh të lejuar siç tregohet në tabelën 3. Në rastin e tregimit shifror gabimi në tregim korrigjohet për gabimin e rrumbullakuar.

Gabimi më i madh i lejuar zbatohet për vlerën neto dhe vlerën e tarës dhe për gjithë ngarkesat e mundshme, duke përjashtuar vlerat e paravendosura të tarës.



TABELA 3
GABIMET MË TË MËDHA TË LEJUARA

Ngarkesa				Gabimi më i madh i lejuar
Klasa I	Klasa II	Klasa III	Klasa IIII	
0 □□m □□□□□ 50 000□e □□□□□□□□□□□□□□ 50 000□e□□□m □□2 00 000 e 200 000 e < m	0 □□m □ 5 000 e 5 000 e < m □□□□ 20 000 e 20 000 e < m □□□□□□□□□e	0 □m □□□□□□□□ 500 e 500 e < m □□□ 2 000 e 2 000 e < m □□10 000 e	0 □□m □□□□□□□□ 50□e 50 e < m□□□□□□□ 00□e 200□e □□m □□□□ 000 e	± 0.5 e ± 1 e ± 1.5 e

4.4.2 Gabimet më të mëdha të lejuara në shërbim janë dy herë më të mëdha se ato të dhëna në pikën 4.4.1

4.5 Rezultatet e peshimit të një peshoreje duhet të jenë të ripërsëritshme, dhe të riprodhueshme nga përdorimi i një tjetër pajisje treguese dhe në përputhje me metodat e tjera të përdorura të balancimit.

4.5 Rezultatet e peshimit duhet të jenë mjaftueshmërisht të pandjeshme ndaj ndryshimeve të pozicionit të ngarkesës mbi marrësin e ngarkesës.

4.6 Peshorja duhet të reagojë ndaj ndryshimeve të vogla të ngarkesës.

4.7 Madhësitë influencuese dhe koha.

4.7.1 Peshoret e klasave II, III dhe IIII, të detyruara për të punuar në një pozicion të pjerrët, duhet të jenë mjaftueshëm të pandjeshme ndaj vendosjes së pjerrët kundrejt asaj që ekziston në kushte normale të përdorimit.

4.7.2 Peshoret duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike brenda kufirit të temperaturës të dhënë nga fabrikuesi. Vlera e këtij kufiri është të paktën e barabartë me:

- 5 °C për peshoret e klasës së I
- 15 °C për peshoret e klasës së II
- 30 °C për peshoret e klasës së III ose IIII

Në mungesë të specifikimeve të fabrikuesit zbatohet kufiri i temperaturës prej -10 °C deri + 40 °C.

4.7.3 Peshoret që punojnë me ushqim nga rrjeti elektrik duhet plotësojnë kërkesat metrologjike nën konditat e rrjetit elektrik brenda kufijve të luhatjeve normale.

Peshoret që punojnë me bateri duhet të tregojnë kurdoherë, kur tensioni zbret poshtë vlerës minimale të kërkuar dhe nën këto rrethana, se ato vazhdojnë të punojnë me saktësi, ose automatikisht dalin jashtë shërbimit.

4.7.4 Peshoret elektronike, përveç atyre të klasës I dhe të klasës II kur e është më e vogël se 1 g, duhet të plotësojnë kërkesat metrologjike nën kondita të një lagështire relative të lartë dhe në kufirin e sipërm të diapazonit të temperaturës së tyre.

4.7.5 Ngarkimi i një peshoreje të klasës II, III ose IIII për një periudhë kohe të zgjatur duhet të ketë një influencë të parëndësishme në tregimin e ngarkesës ose në tregimin e zeros, menjëherë sapo hiqet ngarkesa.

4.7.6 Nën kondita të tjera peshoret ose do të vazhdojnë të funksionojnë në rregull ose të dalin automatikisht jashtë veprimi.

4.8 Projektimi dhe konstruksioni

Kërkesa të përgjithshme

4.8.1 Projektimi dhe konstruksioni i peshoreve duhet të jetë i tillë që ato të ruajnë cilësitë e tyre metrologjike kur instalohen dhe përdoren siç duhet, dhe kur përdoren në një ambient për të cilin ato janë parashikuar. Vlera e masës duhet të tregohet.

4.8.2 Kur ekspozohen ndaj çrregullimeve, peshoret elektronike nuk duhet shfaqin pasoja të gabimeve domethënëse ose, automatikisht t'i zbulojnë dhe tregojnë ato. Me zbulimin e një gabimi të

rëndësishëm, peshoret elektronike duhet të lëshojnë një alarm akustik ose të dukshëm, i cili vazhdon deri kur përdoruesi ndërmerr një veprim korrigjues ose gabimi të zhduket.

4.8.3 Kërkesat e pikave 4.8.1 dhe 4.8.2 duhet të plotësohen mbi baza të qëndrueshme gjatë një periudhe kohe që është normale nga pikëpamja e parashikimit të përdorimit të këtyre peshoreve.

Pajisjet elektronike shifrore gjithmonë duhet të ushtrojnë kontroll të mjaftueshëm të funksionimit të saktë në procesin e matjes të pajisjes treguese, dhe të të gjitha të dhënave të ruajtura apo atyre të dhënave që transferohen.

Mbas zbulimit automatik të një gabimi të rëndësishëm e të qëndrueshëm, peshoret elektronike duhet të lëshojnë një alarm akustik ose të dukshëm, i cili vazhdon deri kur përdoruesi ndërmerr një veprim korrigjues ose gabimi zhduket.

4.8.4 Kur pajisja e jashtme është lidhur me një peshore elektronike nëpërmjet një bashkimi të përshtatshëm, cilësitë metrologjike të peshores nuk duhet të përkeqësohen.

4.8.5 Peshoret nuk duhet të kenë karakteristika të tilla që lehtësojnë përdorimin mashtrues, ndërsa mundësitë për keqpërdorim të paqëllimshëm duhet të jenë minimale. Komponentët, të cilët nuk duhet të çmontohen ose të rregullohen nga përdoruesi, duhet të jenë të siguruara ndaj veprimeve të tilla.

4.8.6 Peshoret duhet të projektohen që të lejojnë që të kryhen lehtësisht kontrollet ligjore të dhëna në këtë rregull teknik.

4.9 Tregimi i rezultateve të peshimit dhe i vlerave të tjera të peshës.

Tregimi i rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës duhet të jetë i saktë, i qartë dhe jo i keqinterpretueshëm dhe pajisja treguese në kondita normale përdorimi duhet të lejojë lexim të lehtë të tregimit.

Emrat dhe simbolet e njëjësive të referuara në pikën 5.1 janë në përputhje me kërkesat e vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 1162, datë 13.8.2008 “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”; me shtimin e simbolit për karatin metrik, “ct”.

Tregimi nuk duhet të mundësohet mbi kapacitetin maksimal (max), të rritur me 9e.

Një pajisje ndihmëse e tregimit lejohet të tregojë vetëm presjen dhjetore. Një pajisje tregimi mund të përdoret vetëm përkohësisht, ndërsa printimi bëhet i papërdorshëm gjatë funksionimit të saj.

Tregimet dytësore mund të shfaqen, por me kushtin që ato të mos ngatërrohen me tregimet fillestare.

4.10 Printimi i rezultateve të peshimit dhe vlerave të tjera të peshës.

Rezultatet e printuara duhet të jenë të sakta, lehtësisht të identifikueshme dhe të qarta. Printimi duhet të jetë i qartë, i lexueshëm, i paheqshëm dhe i qëndrueshëm.

4.11 Nivelimi

Kur është e nevojshme, peshoret duhet të pajisen me një mekanizëm nivelimi dhe një tregues të nivelit, të cilët të jenë me ndjeshmëri të mjaftueshme për të lejuar instalimin e duhur.

4.12 Zerimi

Peshoret duhet të pajisen me mekanizmat e zerimit. Funksionimi i këtyre mekanizmave të mundësojë zerimin dhe të mos shkaktojë rezultate jo të sakta të matjes.

4.13 Mekanizmat e tarës dhe mekanizmat e paravendosjes së tarës

Peshoret mund të kenë një ose më shumë mekanizma tare dhe mekanizma për paravendosjen e tarës. Veprimi i mekanizmave së tarës duhet të mundësojë zerimin e saktë dhe të sigurojë peshimin neto të saktë. Veprimi i mekanizmit të paravendosjes së tarës duhet të sigurojnë përcaktimin e saktë të vlerës neto të llogaritur.

4.14 Peshoret për shitje direkte në publik me kapacitet maksimal jo më të madh se sa 100 kg; kërkesa plotësuese

Peshoret për shitje direkte në publik duhet të tregojnë të gjithë informacionin thelbësor rreth veprimit të peshimit dhe, në rastin e peshoreve me tregues çmimi, të tregojnë qartësisht për konsumatorin vlerën e llogaritur të produktit që blihet.

Vlera që paguhet nëse tregohet, duhet të jetë e saktë.

Peshoret me llogaritje çmimi duhet të shfaqin tregimet thelbësore për një kohë të mjaftueshme, me qëllim që blerësi t'i lexojë ato me lehtësi.



Peshoret me llogaritje çmimi mund të kryejnë funksione të tjera nga ato të peshimit të artikujve dhe të llogaritjes së çmimit vetëm në ato raste, kur të gjitha tregimet në lidhje me këto veprime për blerësin janë të printuara qartë dhe të rregulluara përshtatshërisht në faturë ose në etiketë.

Peshoret nuk duhet të kenë karakteristika që mund të shkaktojnë direkt ose indirekt tregime, interpretimi i të cilave është i vështirë ose jo i drejtpërdrejtë.

Peshoret duhet të mbrojnë konsumatorin kundrejt transaksioneve dhe shitjeve jokorrekte që mund të ndodhin për shkak të funksionimit jo të mirë të tyre.

Nuk lejohen pajisjet treguese ndihmëse dhe pajisjet e tregimit të zgjeruar.

Pajisje shtesë lejohen vetëm nëse ato nuk çojnë në përdorim mashtrimi.

Peshoret e ngjashme me ato që përdoren normalisht për shitje direkte në publik, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e kësaj nënpike duhet të mbajnë afër treguesit markimin e paheqshëm “i papërdorshëm për shitje direkte në publik”.

4.15 Peshoret me tregim të çmimit

Peshoret me tregim të çmimit duhet të plotësojnë kërkesat e peshoreve me tregim të çmimit për shitje direkt në publik, për aq kohë sa ato zbatohen për peshoren në fjalë. Printimi i një tregimi të çmimit nuk duhet të mundësohet poshtë një kapaciteti minimal.

5. Procedurat e vlerësimit të konformitetit

5.1 Shqyrtimi EC i tipit

5.1.1 Shqyrtimi EC i tipit është procedura me anë të së cilës një organizëm europian i notifikuar ose degë e tij i regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar verifikon dhe vlerëson që një instrument, përfaqësues i prodhimit që shqyrtohet, plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik.

5.1.2 Aplikimi për shqyrtimin EC të tipit paraqitet në një organizëm europian i notifikuar ose degë e tij i regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, në rastin kur aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar i tij, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që aplikimi nuk është depozituar në ndonjë organizëm europian i notifikuar ose degë e tij i regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar;

c) dokumentacionin e projektit teknik, siç përshkruhet në pikën 6 të këtij rregulli teknik.

Aplikuesi mban në dispozicion të organit të autorizuar/organizmit europian një peshore, përfaqësuese e prodhimit që shqyrtohet (e cila këtej e tutje quhet “tipi”).

5.1.3 Organizmi europian i notifikuar ose dega e tij i regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar:

a) shqyrton dokumentacionin teknik dhe verifikon nëse tipi është prodhuar në përputhje me atë dokumentacion;

b) bie dakord me aplikantin lidhur me vendin ku do të kryhen shqyrtimet ose testet;

c) kryen ose detyron kryerjen e shqyrtimeve dhe/ose testeve përkatëse për të kontrolluar nëse zgjedhjet e dhëna nga fabrikuesi plotësojnë kërkesat thelbësore atje ku nuk janë zbatuar standardet e harmonizuara;

d) kryen ose detyron kryerjen e shqyrtimeve dhe/ose testeve përkatëse për të kontrolluar nëse, atje ku fabrikuesi ka zgjedhur për të zbatuar standardet përkatës, këto standarde janë zbatuar me efektivitet për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat themelore.

5.1.4 Atje ku tipi plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik, organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar lëshon për aplikantin një certifikatë të miratimit EC të tipit. Certifikata përmban konkluzionet e shqyrtimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e saj, të dhënat e nevojshme për identifikimin e peshores së miratuar dhe nëse kërkohet, një përshkrim të funksionimit të saj. Të gjitha elementet teknike përkatës, të tilla si vizatime dhe skica duhet të aneksohen në certifikatën EC të miratimit të tipit.

Certifikata ka një periudhë vlefshmërie prej 10 vjetësh që nga data e lëshimit dhe mund të rinovohet për një periudhë të mëpasme prej 10 vjetësh.

Në rastin e ndryshime themelore në projektin e peshores, p.sh. si një rezultat i zbatimit të teknikave të reja, vlefshmëria e certifikatës mund të kufizohet në dy vjet dhe të zgjatet për një periudhë trevjeçare.

5.1.5 Çdo organizëm tjetër europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i notifikuar, periodikisht informojnë ministrinë lidhur me:

- a) aplikime të pranuar për shqyrtimin EC të tipit;
- b) certifikata të lëshuara të miratimit EC të tipit;
- c) aplikime të refuzuara për certifikatat mbi tipin;
- d) shtesa dhe amendime që lidhen me certifikatat tashmë të lëshuara.

Çdo degë e organizmit europian të notifikuar i regjistruar në Shqipëri e i miratuar, informon menjëherë ministrinë për tërheqjen e certifikatave të miratimit EC të tipit.

Ministria informon të gjitha organet e miratuara prej saj për këtë qëllim.

5.1.6 Organizmat europianë të notifikuar ose degët e tyre të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar mund të marrin një kopje të certifikatës së miratimit të tipit së bashku me anekset.

5.1.7 Aplikanti duhet të mbajë organizmin europian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar, i cili ka lëshuar certifikatën e miratimit EC të tipit të informuar për çdo modifikim në tipin e miratuar.

Modifikimet në tipin e miratuar duhet të marrin miratim shtesë nga organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar që ka lëshuar certifikatën e miratimit EC të tipit atje ku ndryshime të tilla influencojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik ose në kushtet e parashikuara të përdorimit të instrumentit. Ky miratim shtesë jepet në formën e një shtese në certifikatën origjinale të lëshuar të miratimit CE të tipit.

5.2 Deklarimi i konformitetit EC i tipit (garancia e cilësisë së prodhimit)

5.2.1 Deklarimi i konformitetit EC i tipit (garancia e cilësisë së prodhimit) është procedura me anë të së cilës prodhuesi, i cili plotëson detyrimet e pikës 5.2.2 deklaron se peshoret në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e miratimit EC të tipit dhe se ato plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos në çdo peshore markimin CE dhe mbishkrimet e dhëna në pikën 7, si dhe harton me shkrim një deklaratë të konformitetit.

Markimi CE i konformitetit shoqërohet me numrin e identifikimit të organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar përgjegjës për mbikëqyrjen EC sipas referimit në pikën 5.2.4.

5.2.2 Prodhuesi duhet të zbatojë në mënyrë të përshtatshme një sistem cilësie, siç specifikohet në pikën 5.2.3 dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes EC siç specifikohet në pikën 5.2.4.

5.2.3 Sistemi i cilësisë

5.2.3.1 Prodhuesi i paraqet një aplikimin për miratimin e sistemit të tij të cilësisë te një organizëm europian i notifikuar ose degë e tij i regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar.

Aplikimi përfshin:

- a) zotimin për plotësimin e detyrave që rrjedhin nga sistemi i cilësisë i miratuar,
- b) zotimin për të mirëmbajtur sistemin e aprovuar të cilësisë për të siguruar në vazhdimësi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e tij.

Prodhuesi vë në dispozicion të organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar të gjithë informacionin përkatës, veçanërisht dokumentacionin e sistemit të cilësisë dhe dokumentacionin teknik të peshores.

5.2.3.2 Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhshmërinë e peshoreve me tipin siç përshkruhet në certifikatën e miratimit EC të tipit, si dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e adaptuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen me shkrim në një mënyrë sistematike dhe të rregullt në formë rregullash, procedurash dhe instruksionesh. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të sigurojë një kuptim të drejtë të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe regjistrimeve.

Dokumentacioni duhet të përmbajë në veçanti një përshkrim të përshtatshëm mbi:



a) objektivat e cilësisë dhe strukturën organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë e menaxhimit lidhur me cilësinë e produktit;

b) procesin të prodhimit, kontrollin e cilësisë dhe teknikat e sigurisë dhe matjet sistematike që duhet të përdoren;

c) shqyrtimet dhe testet që duhet të kryhen përpara, gjatë dhe mbas prodhimit, si dhe të frekuencës me të cilën ato kryhen;

d) mjetet monitoruese për arritjen e cilësisë së kërkuar të produktit dhe veprimet efektive të sistemit të cilësisë.

5.2.3.3 Organizmi evropian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar shqyrton dhe vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e dhëna në pikën 5.2.3.2. Ai konsideron përputhshmërinë me këto kërkesa lidhur me sistemet e cilësisë që zbatohen nga standardi përkatës i harmonizuar.

Ai njofton prodhuesin mbi vendimin e tij dhe organizmat europiane të notifikuar ose degët e tyre të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar. Njoftimi për prodhuesin përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe, në rastin e refuzimit, justifikimin për vendimin.

5.2.3.4 Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij mban të informuar organizmin evropian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar që ka miratuar sistemin e cilësisë për çdo përditësim të sistemit të sigurimit të cilësisë në lidhje me ndryshimet që mund të bëhen, p.sh., teknologji të reja apo koncepte të reja të cilësisë.

5.2.3.5 Çdo organizëm evropian i notifikuar ose degë e tij i regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar që tërheq miratimin e sistemit të cilësisë informon organizmat e tjerë të autorizuar.

5.2.4 Mbikëqyrja EC

5.2.4.1 Qëllimi i mbikëqyrjes EC është për të siguruar që prodhuesi i plotëson rregullisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

5.2.4.2 Prodhuesi i jep organizmit evropian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar të drejtën e hyrjes për qëllime inspektimi në sektorët e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit, si dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti mbi:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë,

b) dokumentacionin teknik;

c) regjistrimet e cilësisë si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testeve dhe kalibrimeve, raporte mbi kualifikimin e personelit që ka lidhje me aktivitetin.

Organizmi evropian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar kryen periodikisht kontrole për t'u siguruar se prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë. Ai i jep prodhuesit një raport mbi kontrollin.

Në vazhdim, organizmi evropian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar mund të kryejë vizita të palajmëruara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organizmi evropian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar mund të kryejë kontrole të plota ose të pjesshme. Ai i jep prodhuesit një raport mbi vizitën, dhe kur kërkohet, një raport të kontrollit.

5.2.4.3 Organizmi evropian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar duhet të sigurohet se prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e miratuar të cilësisë.

5.3. Verifikimi EC

5.3.1 Verifikimi EC është procedura me anë të së cilën prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar, siguron dhe deklaron që peshoret, të cilat janë kontrolluar në përputhje me pikën 5.3.3 janë, ku kërkohet, në përputhshmëri me tipin, siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit, si dhe plotësojnë kërkesat e këtij rregulli teknik.

5.3.2 Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme që procesi i prodhimit të sigurojë përputhshmërinë e peshoreve, aty ku zbatohet, me tipin, siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik që zbatohen në to.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij vendos në çdo peshore markimin CE të konformitetit dhe harton me shkrim një deklaratë të konformitetit.

5.3.3 Organi i autorizuar/organizmi europian kryen shqyrtimet dhe testet përkatëse me qëllim që të kontrollojë përputhshmërinë e produktit me kërkesat e këtij rregulli teknik nëpërmjet shqyrtimit dhe testimit të çdo peshoreje, siç specifikohet në pikën 5.3.5.

5.3.4 Për peshoret që nuk janë objekt i miratimit EC të tipit, dokumentacioni që ka lidhje me projektimin e instrumentit siç përcaktohet në pikën 7, duhet të vihet në dispozicion të organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar me kërkesën e tij.

5.3.5 Verifikimi nëpërmjet kontrollit dhe testimit të çdo peshoreje

5.3.5.1 Të gjitha peshoret shqyrtohen dhe testohen individualisht, si është përcaktuar në standardet e harmonizuara përkatëse, ose kryhen teste ekuivalente, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria, aty ku zbatohet, e tyre me tipin, siç përshkruhet në certifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

5.3.5.2 Organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar vendos, ose gjykon për të vendosur, numrin e tij të identifikimit në çdo peshore, që është në përputhshmëri me kërkesat e përcaktuara dhe harton me shkrim një certifikatë të konformitetit lidhur me testet e kryera.

5.3.5.3 Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij siguron që ai është në gjendje të japë, sipas një kërkesë, certifikatat e konformitetit të organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar.

5.4 Verifikimi EC i njësisë

5.4.1 Verifikimi EC i njësisë është procedura me anë të së cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij siguron dhe deklaron që një peshore, përgjithësisht e konstruktuar për një zbatim të veçantë, për të cilën është lëshuar një certifikatë sipas referimit të pikës 5.4.2, plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik që zbatohen në të. Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar vendos në çdo instrument markimin "CE dhe harton me shkrim një deklaratë konformiteti.

5.4.2 Organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar shqyrton peshoren dhe kryen testet përkatëse, siç janë përcaktuar nga standardet përkatës të harmonizuar, ose kryen teste të barasvlershme, për të siguruar përputhshmërinë e saj me kërkesat përkatëse të këtij rregulli teknik.

Organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar vendos, ose gjykon për të vendosur, numrin e tij të identifikimit në çdo peshore përputhshmëria e së cilës është e përcaktuar me kërkesat dhe duke u bazuar në testet e kryera lëshon me shkrim një certifikatë konformiteti.

5.4.3 Qëllimi i dokumentacionit teknik në lidhje me konstruksionin e peshores, siç referohet në pikën 3, është që të mundësojë të vlerësohet përputhshmëria me kërkesat e këtij rregulli teknik, dhe projektimi, prodhimi dhe funksionimi i peshores të jetë kuptuar. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm për organizmin europian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar.

5.4.4 Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij siguron që ai është në gjendje që sipas një kërkesë të japë certifikatat e konformitetit organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar.

5.5 Dispozita të përbashkëta

5.5.1 Deklarimi i konformitetit EC i tipit (garancia e cilësisë së prodhimit), verifikimi EC dhe verifikimi EC i njësisë mund të kryhen në vendet e punës së prodhuesit ose, në çdo vend tjetër nëse transporti në vendin e përdorimit nuk kërkon çmontimin e peshores, nëse vënia në shërbim në vendin e përdorimit nuk kërkon montimin e peshores ose punë tjetër teknike instalimi, e cila mund të ndikojë në funksionimin e peshores dhe nëse, vlera e gravitetit në vendin e vendosjes në shërbim është marrë në konsideratë ose nëse funksionimi i peshores është i pandryshëm ndaj ndryshimeve të gravitetit. Në të gjitha rastet e tjera ato kryhen në vendin e përdorimit të peshores.

5.5.2 Nëse performanca e peshores është e ndryshme ndaj ndryshimeve të gravitetit, procedurat e referuara në pikën 6.5.1 mund të kryhen në dy etapa, ku etapa e dytë përfshin të gjitha shqyrtimet dhe testet, rezultati i të cilave është i varur nga graviteti, ndërsa etapa e parë përfshin të gjitha shqyrtimet dhe testet e tjera.



Etapa e dytë kryhet në vendin e përdorimit të peshores. Shprehja “në vendin e përdorimit të peshores” mund të lexohet si “në zonën e gravitetit të përdorimit të peshores”.

5.5.2.1 Aty ku prodhuesi ka zgjedhur kryerjen në dy etapa të njëjës nga procedurat e përmendura në pikën 5.5.1 dhe atje ku këto dy etapa kryhen nga organizma të ndryshëm europianë të notifikuar ose degët e tyre të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar, një peshore, e cila i është nënshtruar etapës së parë të procedurës në fjalë do të ketë numrin e identifikimit të organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar të përfshirë në etapën e parë.

5.5.2.2 Organizmi europian i notifikuar ose dega e tij e regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar, e cila ka kryer etapën e parë të procedurës duhet të lëshojë për çdo peshore një certifikatë që përmban të dhënat e nevojshme për identifikimin e peshores duke specifikuar shqyrtimet dhe testet që janë kryer.

Organizmi që kryen etapën e dytë të procedurës kryen ato shqyrtime dhe teste që nuk janë kryer akoma.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij siguron që ai është në gjendje të japë, sipas kërkesës, certifikatën e konformitetit organizmit europian të notifikuar ose degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar.

5.5.3 Prodhuesi, i cili ka zgjedhur deklarin e konformitetit EC të tipit (garancia e cilësisë së prodhimit) mund të përdorë të njëjtën procedurë si në etapën e parë ashtu dhe në etapën e dytë ose të vendosë që të vazhdojë me verifikimin EC në etapën e dytë.

5.5.2.4 Markimi CE i konformitetit vendoset në peshore në përfundim të etapës së dytë, së bashku me numrin e identifikimit të organit të autorizuar/organizmit europian, i cili ka marrë pjesë në etapën e dytë.

6. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik duhet të paraqesë projektin, prodhimin dhe funksionimin e produktit në mënyrë të kuptueshme dhe të mundësojë që vlerësimi të bëhet në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik.

Për një vlerësim të përshtatshëm dokumentacioni duhet të përfshijë:

- a) një përshkrim të përgjithshëm të tipit;
- b) projektet konceptuale, vizatimet e prodhimit, skicat e komponentëve, nyjat përbërëse dhe qarqet elektrike;
- c) përshkrime dhe shpjegime të nevojshme për kuptimin e dokumenteve të mësipërme, duke përfshirë edhe funksionimin e peshores;
- d) një listë të standardeve të harmonizuara, të cilat zbatohen plotësisht ose pjesërisht, si dhe përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesave thelbësore aty ku standardet e harmonizuara nuk janë zbatuar;
- e) rezultatet e llogaritjeve projektuese dhe shqyrtimeve të bëra;
- f) raportet e testimit;
- g) certifikatat e miratimit EC të tipit dhe rezultatet e testeve përkatëse të peshoreve duke përmbajtur pjesët identike me ato në projekt.

7. Markimi CE i konformitetit dhe shënimet

7.1 Peshoret që i nënshtrohen procedurës së vlerësimit EC të konformitetit

7.1.1 Këto peshore duhet të kenë të vendosur:

- a) Markimin CE të konformitetit që përfshin simbolin CE siç përshkruhet në pikën 10.
- ii) Numrin/at e identifikimit të organizmit europian të notifikuar ose të degës së tij të regjistruar në Shqipëri dhe i miratuar që ka ose kanë kryer mbikëqyrjen EC ose verifikimin EC.

Markimi dhe shënimet e mësipërme vendosen në peshore të grupuara së bashku dhe në mënyrë të qartë.

b) Një letër ngjitëse me ngjyrë jeshile, në formë katrore me përmasa minimale 12.5 mm x 12.5 mm që ka të vendosur me ngjyrë të zezë germën “M” të madhe të shtypit;

c) shënimet e mëposhtëm:

d) numrin e certifikatës të miratimit EC të tipit dhe atje ku kërkohet;

ii) markën ose emrin e prodhuesit;

iii) klasën e saktësisë, të vendosur brenda një ovaleje ose brenda dy vijave horizontale që bashkohen me dy gjysmërrathë;

iv) kapacitetin maksimal në formën Max;

v) kapacitetin minimal në formën Min ...;

vi) ndarjen verifikuese të shkallës në formën $e = \dots$;

vii) dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur markimi CE i konformitetit, duke shtuar atje ku kërkohet:

viii) numrin e serisë;

ix) për instrumentet që përbëhen nga njësi të ndara, por që grupohen markën identifikuese në çdo njësi;

x) ndarjen e shkallës nëse ajo është e ndryshme nga e , në formën $d = \dots$;

xi) efektin e tarës ngritëse maksimale, në formën $T = + \dots$;

xii) efektin e tarës zbritëse maksimale nëse ai është i ndryshëm nga ai Max, në formën $T = -\dots$;

xiii) ndarjen e tarës nëse ajo është e ndryshme nga d , në formën $dT = \dots$;

xiv) ngarkesën maksimale të sigurisë nëse ajo është e ndryshme nga Max, në formën Lim ...;

xv) kufijtë specifike të temperaturës, në formën ... °C/ ...°C;

xvi) raportin ndërmjet marrësit të ngarkesës dhe ngarkesës.

7.1.2 Peshoret duhet të kenë lehtësitë e nevojshme për vendosjen e markimit CE të konformitetit dhe/ose të shënimeve. Këto duhet të jenë të tilla që të mos mundësohet heqja e markimit CE dhe shënimeve pa i dëmtuar ato dhe të jenë të dukshme kur peshorja është në pozicion të rregullt pune.

7.1.3 Aty ku përdoret një pllakete të dhënash, ajo duhet të mundësojë vulosjen e pllaketes në mënyrë që të mos bëhet heqja e saj pa u shkatërruar. Në rast se pllaketa e të dhënave është e vulosur, ajo duhet të mundësojë vendosjen e një shenjë kontrolli në të.

7.1.4 Shënimet Max, Min, e , d , duhet të jenë vendosur afër tregimit të rezultatit nëse ato nuk janë vendosur në pllaketën e të dhënave.

7.1.5 Çdo pajisje matëse e ngarkesës që është e lidhur ose mund të lidhet me një ose disa marrës ngarkese duhet të mbajë shënimet përkatëse që kanë lidhje me këta marrës ngarkese.

7.3 Peshoret e tjera

Peshoret e tjera duhet të kenë të vendosur:

a) emrin ose markën e prodhuesit;

b) kapacitetin maksimal në formën Max ...;

Këto peshore mund të mos kenë të vendosur etiketën që jepet në pikën 7.1. b).

7.3 Shenja e përdorimit të kufizuar e specifikuar në pikën 3.5

Kjo shenjë përbëhet nga germa e madhe 'M', e printuar me ngjyrë të zezë në një katror me sfond të kuq me madhësi të paktën 25 mm x 25 mm, me dy diagonale që ndërpriten në formë kryqi.

8. Kriteret minimale për miratimin e degëve të organizmave europianë të regjistruar në Shqipëri e të miratuar për kryerjen e detyrave të lidhura me procedurat e referuara në pikën 2.

8.1 Degët e organizmave europianë të regjistruar në Shqipëri e të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë duhet të kenë në dispozicion të tyre stafin e nevojshëm, mjetet dhe pajisjet.

8.2 Stafi i degëve të organizmave europianë të regjistruar në Shqipëri e të miratuar duhet të kenë kompetencën teknike dhe integritetin profesional.

8.3 Degët e organizmave europianë të regjistruar në Shqipëri e të miratuar duhet të punojnë në mënyrë të pavarur nga rrethet, grupet apo personat që kanë interes direkt apo indirekt për peshoret si për kryerjen e testeve, përgatitjen e raporteve, lëshimin e certifikatave dhe mbikëqyrjen e kërkuar nga ky rregull teknik.

8.4 Stafi i degëve të organizmave europianë të regjistruar në Shqipëri e të miratuar duhet të respektojë sekretin profesional.


8.5 Degët e organizmave europianë të regjistruar në Shqipëri e të miratuar zotërojnë e përgjegjësitë civile të mbuluara nga ligji nr. 10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimorë".



Plotësimi i kushteve të dhëna në dy paragrafët e parë duhet që të verifikohet periodikisht nga organet e përcaktuara me ligj.

9. Markimi CE i konformitetit

Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” siç tregohet më poshtë:



Zvogëlimi apo zmadhimi i markimit CE bëhet proporcionalisht në të gjithë hapësirën.

Komponentët e veçantë të markimit CE kanë të njëjtën përmasë vertikale, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se 5 mm.

10. Dispozita përfundimtare

10.1 Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat për të siguruar që peshorët që kanë markimin CE të konformitetit të vlerësuar me kërkesat e këtij rregulli teknik të vazhdojnë të jenë në përputhshmëri me këto kërkesa.

10.2 Çdo vendim i marrë në vijim të këtij rregulli teknik dhe që rezulton në kufizime për vënien në shërbim të një peshoreje duhet të paraqesë arsyet në të cilat mbështetet.

Ky vendim i njoftohet pa vonesë palës së interesuar, e cila në të njëjtën kohë informohet lidhur me mundësitë ligjore të saj dhe për afatet kohore brenda të cilave zbatohen këto mundësi.

10.3 Çdo person fizik apo juridik që vë në përdorim për herë të parë peshore për të cilët zbatohen kërkesat e këtij rregulli teknik, apo që kanë peshore në përgatitje për t'i vënë për herë të parë në përdorim, duhet të njoftojnë për këtë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.

10.4 Njoftimi sipas paragrafit të mësipërm duhet të përmbajë së paku të dhënat që vijojnë:

a) emrin dhe adresën e përdoruesit të peshores;

b) llojin e peshores që është parashikuar të përdoret dhe vendin e përdorimit, i shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të këtij rregulli teknik;

c) emrin e fabrikuesit të peshores;

d) datën e shitjes dhe të fillimit të përdorimit të peshores.

10.5 Të gjitha subjektet duhet të heqin nga përdorimi peshorët që kanë në shërbim, të cilat nuk plotësojnë kërkesat sipas përcaktimeve të pikës 3, brenda datës 31 dhjetor 2016.

VENDIM
Nr. 86, datë 30.1.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT, CERTIFIKIMIT DHE TESTIMIT TË VARIETETEVE PËR FARAT E DRITHËRAVE²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 9, 14 pika 3, 15 pika 3, 16 pika 4, dhe 33 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farave të drithërave, kategoritë, identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e paketimit dhe etiketimit, procedurën e certifikimit, kriteret e ruajtjes, marrjes së mostrave për analiza laboratorike për certifikim, si dhe procedurën e testimit e provat krahasuese për kontrollin e farave të drithërave që vendosen në treg.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

II. KRITERET E TREGTIMIT TË FARAVE TË DRITHËRAVE

1. Kriteret që duhet të plotësojnë farat e drithërave për tregtim janë:

a) të kenë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë e tyre sipas kërkesave të këtij vendimi;

b) të jenë të pajisura me certifikatën zyrtare, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) të jenë të paketuara dhe të etiketuara konform me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij kreu;

ç) varieteti ose hibridi prej të cilit është prodhuar fara të jetë i regjistruar në katalogun kombëtar;

d) të plotësojnë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit, lidhur me masat mbrojtëse kundër futjes apo përhapjes së organizmave të dëmshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave të drithërave

2.1 Sipas prejardhjes, farat e drithërave ndahen në këto kategori:

a) fara parabazë;

b) fara bazë;

ç) riprodhimi i parë;

c) riprodhimi i dytë.

2.2 Farat e riprodhimit të parë dhe farat e riprodhimit të dytë hyjnë në kategorinë e farave të certifikuara.

2.3 Skemat e prodhimit të kategorive të farave të drithërave, sipas grupimit të bimëve të drithërave (bimë drithërash vetëpllenuese dhe bimë drithërash me pllenim të kryqëzuar), bëhen nën monitorimin dhe përgjegjësinë e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (në vazhdim ESHFF).

2.4 Identiteti i farave të drithërave është tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike, me qëllim për ta dalluar, në përdorim, një specie të caktuar nga speciet e tjera. Sipas këtij kriteri, farë drithërash do të konsiderohen farat që rrjedhin nga bimët:

²Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 66/402/KEE të Këshillit, datë 14 qershor 1966 “Për tregtimin e farave të drithërave”; numri CELEX 31966LO402, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 125, datë 11.7.1966, faqe 2298-2308.



a) Tërshëra e zhveshur	Avena nuda L. Avena nuda;
b) Tërshëra e zakonshme dhe tërshëra “bizantine”	Avena comune e avena bizantina;
c) Tërshëra e pyllit (forestiera)	Avena strigosa Schreb;
ç) Elbi	Hordeum vulgare L.;
d) Orizi	Oryza sativa L.;
dh) Thekra	Secale cereale L.;
e) Melekuqja	Sorghum bicolor (L.);
ë) Sorgumi sudanez	Sorghum sudanense;
f) “Gruri i butë”	Triticum aestivum;
g) “Gruri i fortë”	Triticum durum Desf;
gj) “Gruri spelta”	Triticum spelta L.;
h) Misri, përjashtuar misri për kokoshka dhe misri i ëmbël	Zea mais L. (Partim);
i) Sorgumi dyngjyrësh	Sorghum bicolor (L.);
j) Tritikalet, që rrjedhin nga kryqëzimi i një specijeje të gjinisë <i>triticum</i> me një specie të gjinisë <i>secale</i> .	

2.4.1 Farë drithërash do të konsiderohen, gjithashtu, edhe farat që prodhohen nga parcelat e mbjella me:

- varietet me pllenim të lirë, një varietet pak a shumë uniform dhe i qëndrueshëm;
- linja “inbrede”, një linjë mjaft uniforme dhe e qëndrueshme, që arrihet si me anë të vetëpllenimit artificial e shoqëruar me seleksionim përgjatë shumë brezave pasardhës, ashtu dhe me veprime të ngjashme;
- farë hibrid i thjeshtë, që përftohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet dy linjave “inbrede”, të përcaktuar nga seleksioneri;
- farë hibrid i dyfishtë, i cili përftohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet dy hibridëve të thjeshtë, të përcaktuara nga seleksioneri;
- farë hibrid i trefishtë, që përftohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet një linje “inbrede” dhe një hibridi të thjeshtë, të përcaktuar nga seleksioneri;
- dh) farë hibrid “*top cross*”, që përftohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet një linje “inbrede” apo një hibridi të thjeshtë dhe një varieteti me pllenim të lirë, të përcaktuar nga seleksioneri;
- e) farë hibrid ndërvarietor, që përftohet nga riprodhimi i parë i një kryqëzimi ndërmjet bimëve të farave bazë të dyja varieteteve me pllenim të lirë, të përcaktuar nga seleksioneri.

2.5 Cilësia e farave të drithërave përcaktohet nga këta tregues:

- Pastërtia e përgjithshme, që është përqindja e farave të pastra ndaj peshës së tyre të përgjithshme;
- Fuqia mbirëse, që është aftësia e farës së drithërave për të mbirë në kushte të caktuara dhe që përcaktohet nga numri i farave që mbijnë në raport me numrin e farave të vëna për mbirje;
- Energjia mbirëse, e cila është aftësia që ka fara për të mbirë brenda një periudhe kohe të caktuar sipas ISTA-s (Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farave) dhe që shprehet në përqindje;
- Lagështia, që është përqindja e lejuar e lagështirës që mbart fara për t’u paketuar dhe për t’u tregtuar si material mbjellës.

2.6 Normat për treguesit cilësorë të farave të drithërave janë të përcaktuara në tabelën A të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Paketimi dhe etiketimi i farës së drithërave

3.1 Paketimi i “farës bazë” apo i “farës së certifikuar” të çdo kulture dhe lloji shoqërohet me dy lloje etiketash: etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare e lëshuar nga ESHFF-ja. Etiketa zyrtare vërteton që fara e drithërave është certifikuar dhe kontrolluar nga sektori i certifikimit në ESHFF.

3.2 Fara e drithërave të kategorive “fara bazë” dhe “fara e certifikuar” duhet të tregtohet vetëm në lote homogjene dhe të paketuara.

3.3 Paketimet e “farave bazë” dhe të “farave të certifikuar” të çdo kulture dhe lloji duhet të kryhen në mënyrë të tillë që, nëse hapen, mbyllja ose vetë paketimi të lënë gjurmë dëmtimi mbi etiketën zyrtare ose mbi vetë paketimin.

3.4 Ripaketimi i farës së drithërave bëhet në rastin e rikontrollit laboratorik për verifikimin e cilësisë së farës, me kërkesë të furnizuesit. Nëse ripaketohet, ripaketimi dhe data e ripaketimit duhet të shënohen në etiketë nga ESHFF-ja.

3.5 Paketat e “farave parabazë”, të “farave bazë” dhe të “farave të certifikuar” të çdo kulture dhe lloji duhet që:

a) të jenë të pajisura, në pjesën e jashtme, me një etiketë zyrtare, konform me kërkesat e përcaktuara në shtojcën IV të këtij vendimi, dhe në gjuhën shqipe.

b) të përmbajnë një dokument zyrtar të së njëjtës ngjyrë me etiketën, që të pasqyrojë, të paktën, kërkesat e përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të shkronjës “a” të shtojcës IV (I), bashkëlidhur këtij vendimi.

3.6 Gjatë certifikimit zyrtar, autoriteti certifikues verifikon që paketimi i “farës bazë” apo i “farës së certifikuar” të çdo lloji, përmban edhe etiketën e furnizuesit, e cila duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga etiketa zyrtare.

3.7 Kushtet në të cilat farat e shumëzuara nga riprodhimet e “farës parabazë” mund të tregtohen si “fara bazë”, “fara të certifikuar”, “fara të certifikuar të riprodhimit të parë” dhe “fara të certifikuar të riprodhimit të dytë” janë këto:

a) të jenë kontrolluara zyrtarisht nga autoriteti certifikues, në përputhje me kërkesat që zbatohen për certifikimin e “farës bazë”;

b) të jenë të paketuara në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

c) paketat duhet të kenë një etiketë zyrtare, ku të shënohen, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

i) autoriteti certifikues;

ii) numri i referencës së lotit;

iii) muaji dhe viti i vulosjes, ose

iv) muaji dhe viti i marrjes së mostrave zyrtare të fundit, për qëllime certifikimi;

v) speciet, duke shënuar, të paktën, emrin botanik të tyre, që mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emrin e autorit;

vi) varieteti të shënohet, të paktën, me karaktere latine;

vii) të dhënat për farën “parabazë”;

viii) riprodhimi;

ix) të jetë e bardhë me një vijë diagonale vjollcë.

3.8 Çdo trajtim me plehrat e përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve, që i është bërë “farave bazë” dhe “farave të certifikuar”, shënohet në etiketën zyrtare ose në etiketën e furnizuesit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

III. CERTIFIKIMI I FARAVE TË DRITHËRAVE

1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1.1 Procedurat e certifikimit të farave të drithërave realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjektet publike apo private, sipas përcaktimit të kreut IX të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave të drithërave të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre është si më poshtë:

a) Për certifikimin e farave të drithërave pranë autoritetit certifikues, duhet të paraqiten këto dokumente:

i) kërkesa me shkrim për certifikimin e farës së drithërave;

ii) licenca përkatëse e lëshuar nga QKL-ja;

iii) aktkontrolli për caktimin e ngastrës së farës, zbatimin e kërkesave agroteknike dhe teknologjisë së prodhimit të farave sipas metodikave të hartuara për farat e drithërave dhe modelit të dhënë në shtojcën V të këtij vendimi;

iv) certifikata e origjinës, që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;

v) certifikata fitosanitare, lëshuar nga shërbimi fitosanitar;



- vi) aktaprobimi fushor;
 - vii) fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë, për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar nga laborator i miratuar nga ministri;
 - viii) etiketa e prodhuesit;
 - ix) deklarata e konformitetit.
- b) Autoriteti certifikues ndjek këtë procedurë certifikimi:
- i) Bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës së drithërave që do të certifikohet, si dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në katalogun kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e mësipërm, plotëson procesverbalin për “Verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin, si dhe kontrollin e cilësisë së farës së drithërave”;
 - ii) Përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim, në bazë të procesverbalit dhe dokumentacionit të mësipërm;
 - iii) Gjatë vlerësimit të dosjes, duhet të mbahet parasysh që përmbajtja maksimale e lagështirës për “farat bazë” dhe “farat e certifikuara”, të të gjitha llojeve, të jetë jo më shumë se 14%;
 - iv) Në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare, në të cilën shënohen sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;
 - v) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi, sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;
 - vi) Elementet dhe kriteret e përmbajtjes së etiketës duhet të jenë sipas përcaktimeve të shkronjës “A” të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi;
 - vii) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë tërhequr e plotësuar nga prodhuesi sasi të etiketës zyrtare.
- 1.3 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit dhe lëshimi i certifikatës zyrtare duhet të përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.
- 1.4 Nëse subjekti i autorizuar nga ESHFF-ja për kryerjen e procedurave të certifikimit nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar në nënpikën 1.3 të këtij kreu, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë ESHFF-së.
- 1.5 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar në nënpikën 1.3, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
- 1.6 Forma, përmbajtja dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet kërkesës për certifikim jepen në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kriteret e ruajtjes dhe marrja e mostrave të farës së drithërave për certifikim
- 2.1 Farat e drithërave duhet të mbahen në mjedise të përshtatshme, të cilat gjatë përpunimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit të tyre sigurojnë temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknikë për farat e drithërave. Mjediset e përpunimit duhet të jenë të pajisura me impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin dhe paketimin e farave të drithërave. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me aktmiratimin higjieno-sanitar, të lëshuar nga strukturat lokale të shëndetit publik, si dhe me certifikatë për DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim), të lëshuar nga subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi. Farat e drithërave nuk duhet të mbahen në ruajtje më shumë se 3 (tre) vjet.
- 2.2 Fara e drithërave tregtohet si e tillë vetëm pasi të jetë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar. Gjatë përpunimit, farat e drithërave mund të dezinfektohen e peletohen me pesticide e lënde kimike, ushqyese, kjo e shoqëruar me shënimin në etiketën përkatëse.
- 2.3 Furnizuesve të farave të drithërave u lejohet që, në mjediset e tyre, të përpunojnë, paketojnë dhe etiketojnë fara edhe për furnizues të tjerë, të licencuar për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e farave të drithërave.
- 2.4 Procesi i analizës laboratorike të farave të drithërave, për certifikim, ushtrohet për:
- a) lotin e farës, si një sasi e dhënë e farave të drithërave, e një riprodhimi dhe e një kategorie që ka një pastërti varietore;
 - b) mostrën e marrë në një ose në disa pika të lotit të farës;

- c) kampionin fillestar, si një sasi e farave të drithërave që del nga përzierja e mostrave;
- ç) kampionin mesatar, si një pjesë e kampionit fillestar;
- d) provën si një pjesë e kampionit mesatar, sipas përcaktimeve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.5 Mostrat e farave për analizën e farave të drithërave, për qëllim certifikimi, duhet të merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë të autorizuar, në përputhje me metodat teknike të përcaktuara me urdhër të ministrit.

2.6 Për ekzaminimin e farës së drithërave për certifikim, mostrat duhet të nxirren nga lote homogjene. Pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre përcaktohen në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. PROCEDURA DHE METODAT E TESTIMIT TË VARIETETEVE QË REGJISTROHEN NË KATALOGUN KOMBËTAR

1. Procedurat dhe metodat e kryerjes së testimit

1.1 Testimi i një varieteti ka për qëllim kryerjen e provave zyrtare mbi farën për të verifikuar plotësimin e kërkesave për vlerat e kultivimit dhe përdorimit të tyre, për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet, me qëllim regjistrimin në katalogun kombëtar (KK).

1.2 Testimi i varietetit bëhet pas kërkesës së të interesuarit për regjistrimin e këtij varieteti në KK dhe kryhet nga ESHFF-ja ose nga subjekte publike a private të autorizuar, që veprojnë në fushën e bujqësisë, në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” (më tej “autoriteti testues”).

1.3 Aplikanti për regjistrim në KK të varieteteve ose hibrideve të reja paraqet:

- a) kërkesën me shkrim pranë ESHFF-së;
- b) skedën e karakteristikave për kultivarin apo hibridin që do të testohet;
- c) rezultatet e provave të seleksionerit;
- ç) fotografi të bimës apo të frytit;
- d) sasinë e farës për mbjellje, sipas normativave të miratuara me udhëzim të ministrit.

1.4 Procedura e testimit të varietetit, e cila kryhet nga autoriteti testues, përfshin:

- a) zbatimin nga ESHFF-ja të metodikave të hartuara nga UPOV-i;
- b) kryerjen e provave sipas metodikave të sipërpërmendura dhe ndjekjen e fazave të zhvillimit të bimëve;

c) përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar për ta paraqitur në Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar.

1.5 Provat për testimin e varieteteve apo hibrideve për vlerën e kultivimit dhe përdorimit kryhen sipas këtyre afateve:

- a) për varietetet e krijuara në vend, për jo më pak se 2 (dy) vjet;
- b) për varietetet ose hibridet e prodhuara në shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose në shtetet që kanë nënshkruar konventën e UPOV-it, në rastet kur bëhet testimi, kryhet për 1 (një) deri 2 (dy) vjet;
- c) për varietetet ose hibridet që janë prodhuar në vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Europian ose të konventës së UPOV-it, testimi kryhet në jo më pak se 2 (dy) vjet.

1.6 Provat e mostrave të farës së drithërave që hidhen në treg, sipas kërkesave të këtij vendimi, duhet të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në pikat zonale të miratuara nga ministri. Provat të paskontrollit u nënshtrohen:

- a) fara të vjela në vendet e tjera;
- b) fara të përshtatshme për bujqësinë organike;
- c) fara që tregtohen në lidhje me ruajtjen “*in-situ*” dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve gjenetike bimore;

ç) kategoritë e larta të farave të drithërave të prodhuara në vend nga furnizuesit, sipas përcaktimit të pikës 5 të nenit 11 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.



1.7 Provat e paskontrollit të farave të drithërave duhet të aplikohen për të harmonizuar metodat teknike të certifikimit të farave të drithërave, si dhe për të kontrolluar plotësimin e kushteve për farat që testohen, duke siguruar:

- a) pranimin e llojeve të reja të farave të drithërave, të përshtatshme për t'u futur në prodhim;
- b) heqjen nga tregu të llojeve të farave të drithërave të papërshtatshme për prodhimin e gjerë;
- c) cilësinë e farës së prodhuar në një vend tjetër dhe që mendohet të vendoset në tregun e brendshëm;

ç) garancinë për shtimin e llojeve të reja të farave të drithërave, të ardhura nga vende të tjera.

1.8 Forma, përmbajtja dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet kërkesës për testim, jepen në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

SHTOJCA I

KUSHTET QË DUHET TË PËRMBUSHIN PARCELAT E FARAVE TË DRITHËRAVE

1. Parabima e parcelave nuk duhet të ketë qenë e papajtueshme me prodhimin e farave të specieve dhe varieteteve të drithërave. Parcela duhet të jetë e pastër nga bimë që kanë mbirë nga farat e kulturave bimore të mëparshme.

2. Kulturat bujqësore duhet të jenë konform me standardet e mëposhtme në lidhje me distancat nga burimet fqinje të polenit të cilat mund të shkaktojnë pllenim të huaj dhe të padëshirueshëm dhe në veçanti, në rastin e *spp. Sorgum* (melekuqe), nga burime të *Sorgum halepense*:

Kultura	Distanca minimale
<i>Secale cereale</i> (thekër), duke përfshirë hibridet:	
për prodhimin e farave bazë	300 m
për prodhimin e farave të certifikuara	250 m
<i>Sorgum spp.</i> (Melekuqe)	
“x triticosecale” (triticale), varietet me vetëpllenim	
për prodhimin e farave bazë	50 m
për prodhimin e farave të certifikuara	20 m
<i>Zea mays</i> - misri	200 m

Këto distanca mund të mos respektohen në qoftë se ekziston një mbrojtje e mjaftueshme kundër çfarëdo pjalnimi të huaj e të padëshirueshëm.

3. Kultura duhet të ketë identitet dhe pastërti varietore të mjaftueshme ose, në rastin e një linje inbrede, identitet dhe pastërti të mjaftueshme për sa i përket karakteristikave të saj. Për prodhimin e farave të varieteteve hibride, dispozitat e mësipërme aplikohen edhe për karakteristikat e komponentëve, përfshirë sterilitetin mashkullor apo rikthimin e fertilitetit.

Në veçanti, kulturat e orizit (*Oryza sativa*), kokëmadhja/bar kanarinash (*Phalaris canariensis*), thekrës (*Secale cereale*), duke përfshirë hibridet e sorgumit (*spp. Sorgum*) dhe misrit (*Zea mays*) janë konform me normat e tjera ose me kushtet e mëposhtme.

A. Orizi (*Oryza sativa*)

Numri i bimëve të cilat njihen si bimë të egra ose bimë me kokrra të kuqe të mos kalojë:

- për prodhimin e “farave bazë”: 0
 - për prodhimin e “farëve të certifikuara”: 1 për 50 m².
- B. Kokëmadhja/bar kanarinash (*Phalaris canariensis*), thekra (*Secale cereale*) përjashtuar hibridet:
- Numri i bimëve të specieve të kultivuara, të cilat janë të ndryshme nga varieteti të mos kalojë:
- për prodhimin e “farave bazë”: 1 për 30 m²,
 - për prodhimin e “farave të certifikuara”: 1 për 10 m².
- C. Sorgumi (*Spp.Sorghum*)
- a) Për qindja e numrit të bimëve të një specie sorgumi e ndryshme nga specia e kultivuar apo të bimëve, të cilat janë të ndryshme nga linja inbrede ose nga përbërësit e saj të mos kalojë:
- (aa) Për prodhimin e “farave bazë”
- i) në lulëzim: 0.1%;
 - ii) në pjekje (maturim): 0.1%;
- (bb) Për prodhimin e “farave të certifikuara”:
- i) komponentët mashkullorë që kanë lëshuar pjalmën kur bimët e komponentit femëror kanë hapur pistilat: 0.1%;
 - ii) komponentët e llojit femëror:
 - në lulëzim: 0.3%;
 - në pjekje (maturim): 0.1%.
 - b) Për prodhimin e “farave të certifikuara” të varieteteve hibride duhet të respektohen të tjera norma apo kushte si vijon:

(aa) një sasi e mjaftueshme pjalmi duhet të lëshohet nga bimët e komponentit mashkullor ndërsa bimët e komponentit femëror të kenë hapur pistilat;

(bb) kur bimët e komponentit femëror kanë hapur pistilat, përqindja e bimëve të këtij komponenti që ka lëshuar pjalm ose lëshon pjalm të mos kalojë 0.1%.

c) Kulturat e varieteteve me pjalmim të lirë ose varieteteve sintetike të *spp. Sorghum*, duhet të jenë konform me normat në vijim: numri i bimëve të specieve të kultivuara, të cilat dallohen qartësisht që nuk i përkasin varietetit, të mos kalojë:

 - për prodhimin e “farave bazë”: 1 në 30 m²;
 - për prodhimin e “farave të certifikuara”: 1 në 10 m².
- D. Misri (*Zea mays*):
- a) Për qindja e numrit të bimëve të cilat nuk i përkasin varietetit, linjës inbrede apo komponentit të mos kalojë:
- (aa) për prodhimin e “farave bazë”:
- i) linja inbrede: 0.1%
 - ii) hibrid i thjeshtë, secili komponent: 0.1%
 - iii) varietet me pjalmim të lirë: 0.5%;
- (bb) për prodhimin e “farave të certifikuara”:
- i) komponenti i varieteteve hibride:
 - linja inbrede: 0.2%
 - hibrid i thjeshtë: 0.2%
 - varieteti me pjalmim të lirë: 1.0%
 - ii) varietetet me pjalmim të lirë: 1.0%
- b) Për prodhimin e farave hibride, duhet të respektohen norma dhe kushte të tjera si vijon:
- (aa) një sasi e mjaftueshme pjalmi duhet të lëshohet nga bimët e llojit mashkullor kur bimët e llojit femëror janë në lulëzim;
- (bb) kur është e nevojshme, bëhet dhe kastrimi, heqja e xhufkës së komponentit mëmë;
- (cc) kur 5 % ose më shumë e bimëve të komponentit femëror kanë hapur pistilat, përqindja e komponentit femëror që kanë lëshuar ose janë duke lëshuar pjalm nuk do të kalojë:
- 1% të secilit inspektim apo kontroll zyrtar në fushë; dhe
 - 2% të totalit të inspektimeve apo kontroleve zyrtare në fushë.



Bimët konsiderohen se kanë lëshuar ose lëshojnë pjalm në qoftë se, në një gjatësi prej 50 mm ose më shumë prej aksit qendror ose të degëve anësore të lulëzimit, pjalmoret kanë dalë nga lëfostrat dhe kanë lëshuar ose lëshojnë pjalm.

4. Hibridet e thekrës (*Secale cereale*)

a) Kultura e thekrës duhet të jetë konform me normat në vijim për sa i përket distancave nga burimet më të afërta të pjalmimit që mund të rezultojë me pjalmim të huaj të padëshirueshëm.

Kultura	Distanca minimale
Për prodhimin e “farave bazë”:	
- Kur përdoret sterilizimi mashkullor	1000 m
- Kur nuk përdoret sterilizimi mashkullor	600 m
Për prodhimin e “farave të certifikuar”	500 m

b) Kultura duhet të ketë identitet dhe pastërti të mjaftueshme për sa i përket karakteristikave të komponentëve, përfshirë sterilitetin mashkullor. Në veçanti, kultura duhet të jetë konform me norma dhe kushte të tjera si në vijim:

i) numri i bimëve të species së kultivuar, të cilat nuk i përkasin komponentit nuk duhet të kalojë:
- për prodhimin e “farave bazë”: 1 për 30 m²;
- për prodhimin e “farave të certifikuar”: 1 për 10 m²; kjo normë aplikohet vetëm për inspektimet apo kontrollet zyrtare në fushë për komponentin femëror;

ii) për “farat bazë”, nëse përdoret steriliteti mashkullor, niveli i sterilitetit të komponentit mashkull-steril duhet të jetë të paktën 98%.

c) Kur është e nevojshme, “farat e certifikuar” duhet të prodhohen në një kultivim miks, duke kombinuar një komponent femëror ose mashkull-steril dhe një komponent mashkullor, i cili prodhon pjalm.

5. Kultura e destinuar për prodhimin e “farave të certifikuar” të hibrideve të *Avena nuda*, *Avena sativa*, *Avena strigosa*, *Hordeum vulgare*, *Oryza sativa*, *Triticum aestivum*, *Triticum durum*, *Triticum spelta* dhe *x Triticosecale* me vetëpëllim duhet:

a) të jetë konform me normat në vijim për sa u përket distancave nga burimet e afërta të pjalmimit që mund të shkaktojnë një pjalmim të huaj dhe të padëshirueshëm.

Distanca minimale ndërmjet komponentit femëror dhe çfarëdo varieteti tjetër të së njëjtës specie, (komponentit mashkullor), është 25 m.

Kjo distancë mund të mos respektohet nëse ekziston një mbrojtje e mjaftueshme kundër çfarëdo pjalmimi të jashtëm dhe të padëshirueshëm.

b) të ketë një identitet dhe një pastërti të mjaftueshme për sa u përket karakteristikave të komponentëve prindërorë.

Në qoftë se farat janë prodhuar duke përdorur një agjent kimik hibridizues, kultura duhet të jetë konform me normat apo me kushtet e tjera si vijon:

i) pastërtia varietore minimale e secilit komponent është si vijon:

- *Avena nuda*, *Avena sativa*, *Avena strigosa*, *Hordeum vulgare*, *Oryza sativa*, *Triticum aestivum*, *Triticum durum*, *Triticum spelta*: 99.7%

- *x Triticosecale* me vetëpëllim: 99.0%

ii) hibriditeti minimal është 95%. Përqindja e hibriditetit duhet vlerësuar konform me metodat që ndiqen në nivel ndërkombëtar. Në rastet kur hibriditeti përcaktohet gjatë testimit të farave përpara certifikimit, nuk është e nevojshme të vlerësohet gjatë një inspektimi apo kontrolli në fushë.

6. Prezenca e organizmave të dëmshëm që reduktojnë vlerën e përdorimit të farave, në veçanti *Ustilaginaceae* (kërpudhat/bloza), duhet të jenë në nivelin më të ulët të mundshëm.

7. Respektimi i normave apo kushteve të tjera të sipërpërmendura duhet verifikuar, në rastin e “farave bazë”, gjatë inspektimeve (kontrolleve) zyrtare në fushë dhe, në rastin e “farave të certifikuar”, gjatë kontrolleve zyrtare në fushë ose gjatë kontrolleve të zhvilluara nën mbikëqyrjen zyrtare.

Të tilla inspektime apo kontrolle në fushë duhet të zhvillohen sipas kushteve në vijim:

- A. Gjendja dhe stadi i zhvillimit të kulturës të lejojnë një testim të përshtatshëm.
- B. Numri minimal i inspektimeve apo i kontrolleve në fushë që zhvillohen duhet të jetë:
- a) Për *Avena nuda*, *Avena sativa*, *Avena strigosa*, *Hordeum vulgare*, *Oryza sativa*, *Phalaris canariensis*, *x Triticosecale*, *Triticum aestivum*, *Triticum durum*, *Triticum spelta*, *Secale cereale*: 1(një) inspektim apo kontroll.
- b) Për *Sorghum spp.* dhe *Zea mays* gjatë periudhës së lulëzimit:
- (aa) varietet me pjalmim të lirë: 1 inspektim apo kontroll.
- (bb) linjat inbred ose hibridet: 3 (tre) inspektime apo kontrolle.
- Nëse parabima apo bima e vitit në vijim, janë të *Spp. sorghum* apo *Zea mays*, duhet të zhvillohet të paktën një inspektim apo kontroll fushor i veçantë për të verifikuar respektimin e dispozitave të pikës 1 të kësaj shtojce.
- C. Madhësia, numri dhe shpërndarja e parcelave të fushës që duhet të inspektohet apo kontrollohet nga inspektorët apo specialistet e certifikimit, me qëllim që të verifikohet respektimi i dispozitave të kësaj shtojce, duhet të përcaktohen me metoda të përshtatshme.

SHTOJCA II KUSHTET QË DUHET TË PËRMBUSHIN FARAT E DRITHËRAVE

1. Farat e drithërave duhet të kenë një identitet dhe një pastërti varietore të mjaftueshme ose në rastin e linjës inbred, një identitet dhe një pastërti të mjaftueshme për sa i përket karakteristikave të tyre. Për farat e varieteteve hibride, kërkesat e mësipërme janë të domosdoshme edhe për karakteristikat e komponentëve prindëror.

Në veçanti, farat e specieve të renditura më poshtë duhet të jenë konform me normat e tjera të përmendura në vijim:

A. *Avena nuda*, *Avena sativa*, *Avena strigosa*, *Hordeum vulgare*, *Oryza sativa*, *Triticum aestivum*, *Triticum durum*, *Triticum spelta*, përjashtuar hibridet përkatës.

KATEGORIA	Pastërtia varietore minimale (%)
Farat bazë	99.9
Farat e certifikuara, riprodhimi I	99.7
Farat e certifikuara, riprodhimi II	99.0

Pastërtia varietore minimale duhet të kontrollohet nga specialistët e certifikimit zyrtar të ESHFF-së në fushë, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën I.

B. Varietete me vetëpëllim të *x Triticosecale*, përjashtuar hibridet

KATEGORIA	Pastërtia varietore minimale (%)
Farat bazë	99.7
Farat e certifikuara, riprodhimi I	99.0
Farat e certifikuara, riprodhimi II	98.0

Pastërtia varietore minimale duhet të kontrollohet nga specialistët e certifikimit zyrtar të ESHFF-së në fushë, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën I.

C. Hibridet e *Avena nuda*, *Avena sativa*, *Avena strigosa*, *Hordeum vulgare*, *Oryza sativa*, *Triticum aestivum*, *Triticum durum*, *Triticum spelta* dhe *x Triticosecale* me vetëpëllim.

Pastërtia varietore minimale e farave të kategorisë “fara të certifikuara” është 90 %. Pastërtia varietore vlerësohet gjatë testeve zyrtare të mëvonshme në një pjesë të përshtatshme kampionesh.

D. Sorgumi (*Spp. Sorghum*) dhe misri (*Zea mays*):

Nëse për prodhimin e “farave të certifikuara” të varieteteve hibride janë përdorur një komponent femëror ose mashkull-steril dhe një komponent mashkullor që nuk e rikthen sterilitetin mashkullor, farat duhet të prodhohen:



- Duke përzier në përpjesëtime të përshtatshme me varietetin, lotet e farave të prodhuara, duke përdorur nga njëra anë një komponent femëror ose mashkull-steril, dhe nga ana tjetër një komponent femëror ose mashkull-pjellor, ose

- Duke kultivuar komponentin femëror ose mashkull-steril dhe komponentin femëror ose mashkull-pjellor, në përpjesëtime të përshtatshme me varietetin. Përpjesëtimet e këtyre komponentëve kontrollohen gjatë inspektimeve apo kontrolleve në fushë të kryera sipas shtojcës I.

E. Hibridet e thekrës (Secale cereale)

Farat mund të përcaktohen si “fara të certifikuar” vetëm në bazë të rezultateve të një kontrolli zyrtar të mëvonshëm nga specialistët e certifikimit zyrtar në kampione “farash bazë” të marra zyrtarisht, të kryer gjatë periudhës vegetative të farave, për të cilat është paraqitur një kërkesë për certifikim për “farëra të certifikuar”. Ky kontroll ka qëllimin të verifikojë nëse “farat bazë” përmbushim kriteret e përcaktuara për këtë lloj fare, për sa i përket identitetit dhe pastërtisë, karakteristikave të komponentëve, përfshirë këtu dhe sterilitetin mashkullor.

2. Farat duhet të jenë konform me normat apo kushtet e tjera sipas tabelës A që vijon për sa i përket fuqisë mbirëse, pastërtisë analitike dhe përmbajtjes së farërave të bimëve të specieve të tjera.

Tabela A

Rritja e farave minimale	Fuqia minimale mbirëse e farave e lejuar në %	Pastërtia mekanike minimale e lejuar %	Përbajtja maksimale (në numër) e farave të bimëve të specieve të tjera, përfshirë kokrrat e kuqe të <i>Oryza sativa</i> , në një kampion me peshë të përcaktuar në shtojcën III, kolona 4 (totali për kolonë)						
			Specie të tjera bimësh (a)	Kokrra të kuqe të <i>Oryza sativa</i>	Specie të tjera drithërash	Specie bimësh të ndryshme nga drithërat	<i>Avena fatua</i> , <i>Avena sterilis</i> , <i>Lolium temulentum</i>	<i>Raphanus raphanistrum</i> , <i>Agrostemma githago</i>	<i>Panicum spp.</i>
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<i>Avena sativa</i> , <i>Avena strigosa</i> , <i>Hordeum vulgare</i> , <i>Triticum aestivum</i> , <i>Triticum durum</i> , <i>Triticum Spelta</i> :									
- Fara bazë	85	99	4		1 (b)	3	0 (c)	1	
- Fara të certifikuar të riprodhimit 1 dhe 2	85 (d)	98	10		7	7	0 (c)	3	
<i>Avena nuda</i> :									
- Fara bazë	75	99	4		1 (b)	3	0 (c)	1	
- Fara të certifikuar të riprodhimit 1 dhe 2	75 (d)	98	10		7	7	0 (c)	3	
<i>Ryza sativa</i> :									
- Fara bazë	80	98	4	1					1
- Fara të certifikuar të riprodhimit 1	80	98	10	3					3
- Fara të certifikuar të riprodhimit 2	80	98	15	5					3
<i>Secale cereale</i> :									
- Fara bazë	85	98	4		1 (b)	3	0 (c)	1	
- Fara certifikuar	85	98	10		7	7	0 (c)	3	
<i>Phalaris canariensis</i> :									
- Fara bazë	75	98	4		1 (b)		0 (c)		
- Fara të certifikuar	75	98	10		5		0 (c)		
<i>Sorghum spp.</i>	90	98	0						
<i>xTriticosecale</i> :									
- Fara bazë	80	98	4		1 (b)	3	0 (c)	1	
- Fara të certifikuar të riprodhimit 1 dhe 2	80	98	10		7	7	0 (c)	3	
<i>Zea mays</i> cilësia e parë	90	98	0						
<i>Zea mays</i> cilësia e dytë	85	97							



F. Norma ose kushte të tjera që zbatohen sipas tabelës A më sipër.

a) Përmbajtja maksimale e farave përcaktuar në kolonën 4 përfshin edhe farat e specieve të kolonave nga 5 deri tek 10;

b) Një farë e dytë nuk konsiderohet si një papastërti nëse një kampion i dytë me peshë të njëjtë nuk përmban fara të specieve të drithërave të tjera;

c) Prezenca e një fare e *Avena fatua*, *Avena sterilis* ose *Lolium temulentum* në një kampion me peshë të përcaktuar nuk konsiderohet si papastërti nëse një kampion i dytë i të njëjtës peshë nuk përmban fara të këtyre specieve;

d) Në rastin e varieteteve të *Hordeum vulgare* (elbi i zhveshur) fuqia mbirëse minimale e kërkuar ulet në 75% të farave të pastra. Etiketa zyrtare mban fjalët “Kapaciteti minimal i fuqisë mbirëse 75 %”

3. Prezenca e organizmave të dëmshëm, që reduktojnë vlerën e përdorimit të farave, duhet të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm.

Në veçanti, farat duhet të jenë konform me normat në vijim për sa i përket urthit të grurit (*Claviceps purpurea*). Numri maksimal i skleroteve apo fragmenteve të sklerotieve në një kampion me peshë të specifikuar në kolonën 3 të shtojcës III.

Kategoria	Claviceps purpurea
Drithëra të ndryshme nga hibridet e <i>Secale cereale</i> :	
- Fara bazë	1
- Fara të certifikuara	3
Hibride të <i>Secale cereale</i>	
- Fara bazë	1
- Fara të certifikuara	4*

(*) Prezenca e 5 sklerotiave apo fragmente të sklerotias në një kampion me peshë të përcaktuar duhet të konsiderohet si konform me normat nëse një kampion i dytë i së njëjtës peshë përmban jo më shumë se 4 sklerotia apo fragmente sklerotia.

SHTOJCA III PESHA E LOTEVE DHE E KAMPIONEVE (MOSTRAVE)

Speciet	Pesha maksimale e një loti (ton)	Pesha minimale e një kampioni të marrë nga një lot (gram)	Pesha e kampionit për përcaktimin e numrit të parashikuar në kolonat nga 4-10 të tabelës së shtojcës II, pika 2, germa A dhe e shtojcës II, pika 3 (gram)
1	2	3	4
<i>Avena nuda</i> , <i>Avena sativa</i> , <i>Avena strigosa</i> , <i>Hordeum vulgare</i> , <i>Triticum aestivum</i> , <i>Triticum durum</i> , <i>Triticum spelta</i> , <i>Secale cereale</i> , <i>xTriticosecale</i>	30	1000	500
<i>Phalaris canariensis</i>	10	400	200
<i>Oryza sativa</i>	30	500	500
<i>Sorghum bicolor</i> , <i>Sorghum bicolor x Sorghum sudanense</i>	30	1000	900
<i>Sorghum sudanense</i>	10	1000	900
<i>Zea mays</i> , fara bazë të linjave inbred	40	250	250
<i>Zea mays</i> , fara bazë me përjashtim të linjave inbred	40	1000	1000

Pesha maksimale e një loti nuk mund të tejkalohet me më shumë se 5 %

SHTOJCA IV ETIKETIMI

A. ETIKETA ZYRTARE

I. Informacioni i kërkuar

a) Për “farën bazë” dhe “farën e certifikuar”:

1. Autoriteti certifikues ose inicialet e tij;
2. Numri i serisë së etiketës;
3. Numrin e referencës për lotin, si dhe datën e lëshimit të etiketës;
4. Specia, treguar të paktën nën emrin e saj botanik, i cili mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emra të autorëve, me germa latine.
5. Varieteti të tregohet në germa latine;
6. Kategoria;
7. Vendi i prodhimit;
8. Deklarimi i peshës;
9. Kur janë përdorur pesticide të granuluara ose substanca të tjera të peletuara, duhet të deklarohet edhe natyra e pesticideve;
10. Kur fuqia mbirëse është rianalizuar, jepen fjalët “rianalizuar ... (muaji dhe viti)” dhe shërbimi përgjegjës për rianalizimin e të tillave.
11. Përmasat minimale të etiketës 110 × 67 mm.

B. Ngjyra e etiketës dhe dokumenti brenda paketës

Etiketa duhet të jetë në ngjyrë të bardhë me një vijë ngjyrë vjollcë diagonale për “farat para bazë”, me ngjyrë të bardhë për “farat bazë”, me ngjyrë blu për “farat e certifikuara” dhe farat e certifikuara të riprodhimit të parë, me ngjyrë të kuqe për farat e certifikuara të riprodhimit të dytë. Dokumenti duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën. Dokumenti nuk është i domosdoshëm nëse kërkesat janë të printuara me bojë të pashlyeshme mbi paketim ose në qoftë se përdoret një etiketë ngjitëse ose një etiketë e përbërë nga një material rezistent.



SHTOJCA V
FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT QË I BASHKËNGJITET KËRKESËS PËR
CERTIFIKIM

Kërkesë për aplikim

Drejtuar: Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF)

Tiranë

Për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, parashikuar në nenin 12 të ligjit nr.
10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”

Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri:
2. Adresa:
3. Emërtimi i subjektit dhe adresa:
4. Nr. NUIS: (nga QKR)

Të dhëna për përfaqësuesin e autorizuar:

1. Emri e mbiemri:
2. Adresa:
3. Nr. personal i identifikimit:

Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	*
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Afati kohor i tregimit:

Furnizuesi:

.....
Emri, mbiemri, firma dhe vula

Vendi dhe data:

ENTI SHETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL
MBI CAKTIMIN E NGASTRËS SË FARËS

Mbahet sot, më datë, në fermën/ekonominë, fshati, komuna, qarku....., për caktimin e ngarkesës së farës të kulturës, kultivari, (hibridi), që do të mbillet me farë të riprodhimit, gjatë vitit

Kjo ngastër fare caktohet në ekonominë e z....., me sip.ha, në kushte (mbi ose nën ujë) dhe me distancë izolimi në hapësirë nga kultivarët e tjerë prejml.

Për realizmin e prodhimit të farës prejkv, furnizuesi merr përsipër të zbatojë këto hallka të teknologjisë:

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....
- 5.....
- 6.....

Procesverbali mbahet në tri (3) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti i farave të DRB-së përkatëse dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit të Entit Shtetëror të Farave dhe të Fidanëve.

FURNIZUESI

SPEC. FAR. DRB-së

SPEC. I CERTIFIKIMIT ZYRTAR ESHFF



ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

CERTIFIKATË E ORIGINËS
PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND
(bazuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, neni 16/c).

Në mbështetje të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 16/c” nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore lëshoj këtë certifikatë origjine, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me të dhënat e mëposhtme:

Specia
Varieteti
Riprodhimi
Numri referencës
Numri i serisë etiketës zyrtare
Viti i prodhimit
Vend origjina

FURNIZUESI

.....
(firma, vula)

Tiranë, më.....

ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI CERTIFIKIMIT ZYRTAR

AKTKONTROLI
PËR PARCELËN E FARËS

(Bazuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, neni 16/a “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”)

I mbajtur sot, më datë, në parcelat e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, z....., qarku....., komuna....., parcela (vendndodhja)..... mbi zbatimin e teknologjisë për prodhimin e farës specia, kultivari....., riprodhimi, të mbjella në një sipërfaqe prej ha.

Nga kontrolli zyrtar rezultoi se janë zbatuar këto kushte teknike të përcaktuara:

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Ky aktkontroll mbahet në 3 (tre) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti farave të DRB-së përkatëse dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit zyrtar pranë ESHFF.

FURNIZUESI

SPEC. FAR. DRB-së

SPEC. I CERTIFIKIMIT ZYRTAR ESHFF



AKTAPROBIMI
PËR NGASTRËN E PRODHIMIT TË FARËS
(Bazuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, neni 16, pika 1/a)

Sot, më datë nga specialistët e sektorit certifikimit zyrtar të ESHFF-së.
Z....., për kryerjen e aprovimit fushor të ngastrës
së farës (nr. ose emri)....., në ekonominë e furnizuesit z., fshati
....., komuna

1. Nga të dhënat cilësore të farës rezulton:

Ngastra është mbjellë me farë të species,, kultivari.....
riprodhimi, sipërfaqjaha, dokumenti i origjinës.....
.....

2. Mbas verifikimi rezulton se:

- Është siguruar izolimiml.
- Është zbatuar teknologjia, sipërfaqja e vlefshme për farëha,
Kultivari (hibridi), riprodhimi, sasia e farës që parashikohet të
merretkv, kategoria

3. Gjendja e zhvillimit të bimëve në çastin e aprobimit paraqitet:

.....
.....
.....

4. Treguesit e aprobimit fushor:

Pastërtia varietore% (.....)
Pastërtia nga barërat e këqija% (.....)
Prekjet nga sëmundjet virusale% (.....)
Prekjet nga sëmundjet kërpudhore% (.....)
a) (.....)
a) (.....)
c) Dëmtime nga dëmtuesit (.....)

5. Detyrimet e furnizuesit për trajtimin deri në tregtim:

.....
.....
.....
.....

FURNIZUESI

GRUPI I APROBIMIT

..... () () ()

DEKLARATË KONFORMITETI

Unë i nënshkruari,, me licencë nr., datë, me NUIS nr....., datë, me adresë, sot më datë, deklaroj në përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor..... i prodhuar nga ana ime është konform këtij specifikimi teknik:

1. Është i shoqëruar me certifikatën e origjinës nr., datë
2. Është i shoqëruar me certifikatën fitosanitare nr., datë
3. Është i shoqëruar me rezultatin e analizës nr., datë
4. Specia
5. Varieteti
6. Roprodhimi
7. Cilësia
8. Është i ambalazhuar në, me peshë
9. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara nga

dhe i përket lotit nr.

Lëshoj këtë deklaratë konfirmimit komform ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 11 dhe 12 dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

DEKLARUESI

(.....

më datë



ETIKETA E PRODHUESIT

Emri i subjektit furnizues
 Numri NUIS
 Numri i licencës
 Vendi i prodhimit
 Specia
 Fuqia mbirëse
 Data e analizës
 Trajtimi (emri i pesticidit)
 Data e paketimit
 Peshë e njësisë së paketimit

ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL

MBI VERIFIKIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, DOKUMENTACIONIT SI DHE KONTROLLIN E CILËSISË SË FARËS

Në zbatim të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, mes specialistëve të certifikimit zyrtar z..... dhe furnizuesi, sot më datë, mbahet ky procesverbal, për verifikimin e treguesve cilësorë dhe dokumentacionin për farën e prodhuar si vijon:

1. Furnizuesi, ka prodhuar farë të species, me këta tregues:

- a) Varieteti
- b) Riprodhimi
- c) Viti i prodhimit.....
- d) Kontingjenti
- e) Nr. i lotit
- f) Etiketa me nr. serie.....

Dokument që disponon:

- a) Certifikatë origjine nr., datë
- b) Certifikatë fitosanitare nr., datë
- c) Fletanalize nr., datë
- d) Certifikatë OECD nr., datë
- e) Aktaprobimi nr., datë
- f) Deklaratë konfirmiteti nr., datë
- g) Procesverbali i kontrollit nr., datë

Nga verifikimit i dokumenteve, si dhe nga rezultatet e analizave laboratorike rezulton se fara është e prodhuar në përputhje me specifikimet teknike. Për këtë duhet të pajiset me certifikatë garancie pasi subjekti të shlyej tarifën e certifikimit në shumën lekë.

FURNIZUESI

SPECIALISTËT E CERTIFIKIMIT ZYRTAR

.....

(.....) (.....)

ENTI SHITËTËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

ETIKETA ZYRTARE
(për farat e drithërave)

Nr. i serisë
Specia
Variateti
Kategoria
Nr. i lotit
Emri i subjektit prodhues
Vendi i prodhimit
Pesha neto e pakos
Data
Rianalizuar: PO / JO Data rianalizimit:.....
Trajtuar me pesticide ose substanca të tjera kimike: PO / JO
Emri i pesticidit ose i substancës:.....



MINISTRIA E BUJQËSISË USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
LABORATORI QENDROR I TESTIMIT TË FARAVE

Vula e laboratorit

FLETANALIZA E LOTIT TË FARËS

E LËSHUAR PËR APLIKANTIN PA PËRGJEGJËSINË E LABORATORIT				
Emri i aplikantit				
Specia	Kultivari	Kategoria	Pesha e lotit	etj.

INFORMACION

Laboratori i testimit	Shtetëror
Mostra e sjellë nga	Zyrtare
Nr. i lotit	Natyra e certifikatës
Vula e lotit	

Nr. i mbajtësve	Data e mostrimit	Data e pranimit	Data e testimit	Numri i testit

REZULTATI I ANALIZËS

Emri shkencor i species

Pastërtia			Nr. i ditëve të testit	Mbirja					Lagështia %
% në peshë				në %					
Farë e pastër	Lëndë inerte	Fara të tjera	Filiza normalë	Fara të forta	Fara të freskëta	Fara anormale	Fara të vdekura		

Lloji i lëndës inerte.....

Fara të tjera

Përgjegjës i laboratorit

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE AUTORITETI CERTIFIKUES

CERTIFIKATË ZYRTARE

PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND

/ FARËRA /

NR. _____, DATË _____.

Në mbështetje të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimorë”, neni 17 dhe 18, sektori i certifikimit zyrtar, pasi administroi dokumentacionin teknik të përcaktuar në nenin 15 dhe 16 të këtij ligji, dhe e vlerësoi atë të rregullt, lëshon këtë certifikatë zyrtare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, farë drithërash të prodhuar në vend, me të cilën konfirmon se:

Loti i farave prodhuar nga furnizuesi _____, sipas procedurave teknike të përcaktuara, është pajisur me etiketën zyrtare të lëshuar nga ESHFF dhe ka të dhënat që vijon;

Speciet
Varietetet në %
Kodi furnizuesit
Pesha e lotit
Lloji i njësisë së paketimit
Pesha e njësisë së paketimit
Numri i serisë të etiketës zyrtare
Numri i analizës kontrollit, ESHFF
Ngjyra e etiketës zyrtare

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PËRGJEGJËSI

Tiranë më



SHTOJCA VI

A. KËRKESË

ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

PËR REGJISTRIMIN E VARIETETIT/ SPECIES OSE HIBRIDIT.....

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e krijuesit/prodhuesit/importuesit, kërkoj regjistrimin e varieteteve/specieve ose hibridit sipas kërkesave të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” (varietetit/specia ose hibridi _____)

Varieteti/hibridi rrjedh _____ (përmend prindërit që janë kryqëzuar ose sisteme të tjera të krijimit të tij). Në rastin e hibridit trego formulën e saktë, duke theksuar nëse bëhet fjalë ose jo për hibride me formulë të thjeshtë.

Institucioni (ferma/ekonomia) ku mbahet varieteti i pastër ndodhet në qarkun _____, komunën _____ (ose bashkinë) _____ fshatin _____ dhe nëse është importuar, ardhur nga _____ (shteti).

Unë i nënshkruari _____ deklaroj se për këtë varietet është/nuk është paraqitur, kërkesa për regjistrimin e tij në vendet e BE-së ose vende të tjera që zbatojnë skemat e testimi, të cilat përputhen me kërkesat e këtij vendimi. Në rast se është paraqitur kërkesë për regjistrim, për varietetet ose hibridet e importuara përmend shtetin ku është aplikuar për regjistrim. (shteti: _____).

Bashkëngjitur do të gjeni:

- Përshkrimin e varietetit ose hibridit në skedën përkatëse;
- Riprodhime fotografike ose fotografi të bimës ose pjesëve të saj që shërbejnë për identifikimin e saktë të varietetit/hibridit;
- Rezultatet e provave eksperimentale të kryera në vendin tonë ose jashtë tij.

KËRKUESI (ADRESA) _____

Firma _____

Data _____

B. SASITË E KAMPIONIT TË FARËS PËR PROVA PËR TESTIM

KULTURA BUJQËSORE

- Drithërat që mbillen në vjeshtë 15 kg farë për 2 vjet rresht + rreth 600 kallinj.
- Drithërat që mbillen në pranverë (elbi, tërshëra) 15 kg farë për 2 vjet rresht + rreth 600 kallinj.
- Misri 3 kg farë + 0.5 kg farë për çdo prind.
- Oriz 15 kg farë për 2 vjet rresht.

VENDIM
Nr. 87, datë 30.1.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT, CERTIFIKIMIT DHE TESTIMIT TË FARAVE FORAGJERE³

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9 të nenit 4, të pikës 3 të nenit 14, të pikës 3 të nenit 15, të pikës 4 të nenit 16, të pikës 4 të nenit 17, të pikës 1 të nenit 18 dhe të nenit 33 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farave foragjere e të farave foragjere të përziera, kategoritë, identitetin dhe cilësinë e farave foragjere, rregullat e paketimit e të etiketimit, procedurën e certifikimit, kriteret e ruajtjes, marrjes së mostrave për analiza laboratorike për certifikim, si dhe procedurën e testimit e provat krahasuese për kontrollin e farave foragjere që vendosen në treg.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

II. KRITERET E TREGTIMIT TË FARAVE FORAGJERE

1. Kriteret për tregtimin e farave foragjere dhe farave foragjere të përziera

Kriteret që duhet të plotësojë fara foragjere dhe fara foragjere e përzier për tregtim janë:

- a) Të kenë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë sipas kërkesave të këtij vendimi;
- b) Të jenë të pajisura me certifikatën zyrtare sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V bashkëlidhur këtij vendimi;
- c) Të jenë të paketuara dhe të etiketuara në përputhje me kriteret e pikës 3 të këtij kreu;
- ç) Varieteti ose hibridi prej të cilit është prodhuar fara të jetë i regjistruar në Katalogun Kombëtar;
- d) Farat foragjere të përziera të kenë në përbërje të tyre jo më pak se dy specie ose varietete të ndryshme, sipas kërkesës së furnizuesit dhe qëllimit të përdorimit;
- dh) Farat foragjere të përziera të përmbajnë si përbërës të përzierjeve të tyre vetëm fara nga bimët foragjere të listuara në shtojcën VII të këtij vendimi;
- e) Përzierjet mund të përmbajnë fara të bimëve foragjere dhe fara të bimëve që s’janë bimë foragjere në kuptimin e këtij vendimi, në rastet kur përdoren për ruajtjen e mjedisit natyror në funksion të mbrojtjes së burimeve gjenetike;
- ë) Të plotësojnë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit, lidhur me masat mbrojtëse kundër futjes apo përhapjes së organizmave të dëmshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave foragjere

2.1 Sipas prejardhjes, farat foragjere ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- a) Fara parabazë;
- b) Fara bazë;
- c) Riprodhimi i parë;
- ç) Riprodhimi i dytë.

³Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën 66/401/KEE të Këshillit, datë 14 qershor 1966 “Për tregtimin e farave foragjere”; numri CELEX 31966LO401, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 125, datë 11.7.1966, faqe 2309-2319.



2.2 Farat parabazë përfitohen nga shumëzimi i farave në farishten e shumëzimit të farave të zgjedhura nën përgjegjësinë e seleksionerit për mbrojtjen e varietetit.

2.3 Farat bazë përfitohen nga shumëzimi i farës parabazë, nën përgjegjësinë e seleksionerit, sipas metodave të seleksionimit për mbrojtjen e varietetit dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II.

2.4 Fara të riprodhimit të parë janë farat foragjere që përfitohen nga shumëzimi i farave bazë ose, nëse e përcakton seleksioneri, nga fara e një riprodhimi më të hershëm se fara bazë dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II.

2.5 Fara të riprodhimit të dytë përfitohen nga shumëzimi i farave të riprodhimit të parë ose, nëse e përcakton seleksioneri, nga fara të një riprodhimi më të hershëm dhe që përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcat I dhe II.

2.6 Farat foragjere të riprodhimit të parë dhe riprodhimit të dytë futen në kategorinë fara të certifikuar.

2.7 Skemat e prodhimit të kategorive të farave foragjere, sipas grupimit të bimëve (bimë vetëpllenuese dhe të kryqëzuara), është detyrë e institucioneve shkencore dhe individëve të veçantë nën monitorimin dhe përgjegjësinë e ESHFF-së.

2.8 Identiteti i farave foragjere është tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike, si dhe qëllimi i përdorimit të një specie të caktuar për ta dalluar nga speciet e tjera. Bimët, nga të cilat prodhohen farat foragjere sipas kriterëve të këtij vendimi, janë përcaktuar në shtojcën VII bashkëlidhur.

2.9 Cilësia e farave foragjere përcaktohet nga këta tregues:

a) Pastërtia e përgjithshme, e cila është peshë në përqindje e farave të pastra ndaj peshës së përgjithshme të farës;

b) Fuqia mbirëse, e cila është aftësia e farës për të mbirë në kushte të caktuara dhe përcaktohet nga numri i farave që mbijnë në raport me numrin e farave të vënë për mbirje;

c) Energjia mbirëse, e cila është aftësia që ka fara për të mbirë brenda një periudhe kohe të caktuar (sipas Shoqatës Ndërkombëtare të Testimit të Farërave, ISTA) dhe shprehet në përqindje;

ç) Lagështia e farave, e cila është përqindja e lejuar e lagështirës që mbart fara për t'u paketuar dhe për t'u tregtuar si material mbjellës.

2.10 Normat për treguesit cilësorë të farave foragjere janë të përcaktuara në tabelën A të shtojcës II.

3. Paketimi dhe etiketimi i farave foragjere

3.1 Paketimi i “farës bazë” dhe “farës së certifikuar” të çdo kulture dhe lloji shoqërohet me dy lloj etiketash, që janë etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare që përgatitet dhe lëshohet në treg nga ESHFF-ja. Etiketa zyrtare vërteton që fara foragjere është certifikuar dhe kontrolluar nga sektori i certifikimit në ESHFF.

3.2 Farat foragjere të kategorive “farat bazë” dhe “farat e certifikuar”, të tregtohen vetëm në lote homogjene të mbyllura me paketim.

3.3 Paketimet e “farave bazë” dhe “farave të certifikuar” të çdo kulture dhe lloji duhet të kryhen në mënyrë të tillë që nëse hapen, mbyllja ose vetëpaketimi të lënë gjurmë dëmtimi mbi etiketën zyrtare ose mbi vetë paketimin.

3.4 Ripaketimi i farave foragjere bëhet në rastin e rikontrollit laboratorik për verifikimin e cilësisë së farës me kërkesë të furnizuesit. Nëse ripaketohet, ripaketimi dhe data e ripaketimit duhet të shënohet në etiketë nga ESHFF-ja.

3.5 Paketat e “farave parabazë”, “farave bazë” dhe të “farave të certifikuar” të çdo lloji duhet:

a) të jenë të pajisura në pjesën e jashtme me një etiketë zyrtare, që plotëson kushtet e përcaktuara në shtojcën IV dhe në gjuhën shqipe;

b) të përmbajë një dokument zyrtar, në të njëjtën ngjyrë me etiketën, që të pasqyrojë të paktën informacionin e kërkuar në shtojcën IV, (I) (a) (3), (4) dhe (5). Ky dokument duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën zyrtare të përmendur në shkronjën “a”.

3.6 Gjatë certifikimit zyrtar, autoriteti certifikues verifikon që paketimi i “farës bazë” apo “farës së certifikuar” të çdo lloji përmban edhe etiketën e furnizuesit, e cila duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga etiketa zyrtare.

3.7 Farat e shumëzuara nga riprodhimet e “farës parabazë” mund të tregtohen si “fara bazë”, “fara të certifikuara”, “fara të certifikuara të riprodhimit të parë” dhe “fara të certifikuara të riprodhimit të dytë” kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të jenë kontrolluar zyrtarisht nga autoriteti certifikues në përputhje me kërkesat që zbatohen për certifikimin e “farës bazë”;
- b) Të jenë të paketuara në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;
- c) Paketat duhet të kenë etiketën zyrtare, ku të shënohen të paktën të dhënat e mëposhtme:
 - i) autoriteti certifikues dhe shteti përkatës ose shkurtimet e tyre dalluese;
 - ii) numri i referencës së lotit;
 - iii) muaji dhe viti i vuloşjes; ose
 - iv) muaji dhe viti i marrjes së mostrave zyrtare të fundit, për qëllime certifikimi;
 - v) speciet, duke shënuar të paktën emrin botanik të tyre, të cilët mund të jepen në formë të shkurtuar dhe pa emrin e autorit;
 - vi) varieteti të shënohet të paktën me karaktere latine;
 - vii) të dhënat për “farën parabazë”;
 - viii) riprodhimi;
 - ix) të jetë e bardhë me një vijë diagonale vjollcë.

3.8 Paketat e vogla të farave foragjere duhet:

- a) të mbajnë në pjesën e jashtme etiketën e furnizuesit, një përshkrim të shtypur në gjuhën shqipe, në përputhje me përcaktimet e shtojcës IV. Kur paketat janë transparente, kjo etiketë mund të vendoset brenda ambalazhit, me kusht që të jetë i mundur leximi. Ngjyra e etiketës do të jetë sipas përcaktimit të pikës 3.7 shkronja “c” nënndarja “ix” të këtij kapitulli;
- b) të mbajnë në pjesën e jashtme ose në etiketën e furnizuesit një numër të caktuar serial zyrtar.

3.9 Çdo trajtim me plehurat e përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve, që i është bërë “farave bazë” dhe “farave të certifikuara”, shënohet në etiketën zyrtare ose në etiketën e furnizuesit sipas modelit të përcaktuar në shtojcën V.

III. CERTIFIKIMI I FARAVE FORAGJERE

1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1.1 Procedurat e certifikimit të farave foragjere realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte publike apo private sipas përcaktimit në kreun IX të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farave foragjere të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre janë, si më poshtë vijon:

- a) Për certifikimin e farave foragjere pranë autoritetit certifikues duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:
 - i) Kërkesa me shkrim për certifikimin e farës foragjere;
 - ii) Licenca përkatëse e lëshuar nga QKL-ja;
 - iii) Aktkontrolli për caktimin e ngastrës së farës, zbatimin e kërkesave agroteknike dhe teknologjisë së prodhimit të farave sipas metodikave të hartuara për farat foragjere dhe modelit të dhënë në shtojcën V;
 - iv) Certifikata e origjinës që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;
 - v) Certifikata fitosanitare, lëshuar nga shërbimi fitosanitar;
 - vi) Aktaprobimi fushor;
 - vii) Fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë, për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar nga laboratorit i miratuar nga ministri;
 - viii) Etiketa e prodhuesit;
 - ix) Deklarata e konformitetit;
- b) Autoriteti certifikues për procedurën e certifikimit ndjek hapat, si më poshtë vijon:



i) Bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës foragjere, që do të certifikohet si dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e sipërpërmendur, plotëson procesverbalin për “Verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin, si dhe kontrollin e cilësisë së farës foragjere”;

ii) Përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim në bazë të procesverbalit dhe dokumentacionit të sipërpërmendur;

iii) Gjatë vlerësimit të dosjes, duhet të mbahet parasysh që përmbajtja maksimale e lagështirës për “farat bazë” dhe “farat e certifikuara” të të gjitha llojeve të jetë jo më shumë se 14%;

iv) Në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare në të cilën shënohen sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

v) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

vi) Elementet dhe kriteret e etiketës duhet të jenë sipas ndarjes “A” të shtojcës IV të këtij vendimi;

vii) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë tërhequr e plotësuar nga prodhuesi sasi të etiketave zyrtare.

1.3 Procedurat për certifikimin zyrtar të farave foragjere të përziera kryhet veçmas për çdo përbërës dhe bazohet në procedurën që aplikohet për certifikimin e farave sipas pikës 1.2 më sipër. Në të dhënat e etiketës zyrtare dhe të etiketës së prodhuesit krahas treguesve të tjerë shënohet “farë e përzier”, si dhe raporti i përbërësve në përzierje. Certifikata zyrtare për farat foragjere të përziera plotësohet për tërheqjes së etiketave zyrtare për këtë kategori farash. Etiketa e paketave të farave foragjere të përziera është me ngjyrë jeshile.

1.4 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit, si dhe lëshimi i certifikatës zyrtare të përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.

1.5 Për rastet kur ESHFF-ja autorizon kryerjen e procedurave të certifikimit dhe subjekti i autorizuar nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë i interesuari dorëzon ankesë pranë ESHFF-së.

1.6 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë i interesuari dorëzon ankesën pranë Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

1.7 Farat e bimëve foragjere të renditura më poshtë, nuk mund të hidhen në treg si fara foragjere të përziera, nëse nuk janë të certifikuara zyrtarisht si “farë bazë” ose “farë e certifikuar”,

Brassica napus L. napobrassica	Sinapi;
Brassica oleracea L.	Lakra e zakonshme;
Dactylis glomerata L.	Telishi lëmshor;
Festuca arundinacea	Bishtpelëza si kallam;
Festuca pratensis	Bishtpelëza e livadhët;
Festuca rubra L. × Festulolium	Bishtpelëza e kuqe;
Galega orientalis Lam. fodder galega	Bar qerbashi;
Lolium multiflorum Lam.	Egjëra shumëlulëshe;
Lolium perenne L.	Egjëra shumëvjeçare;
Phleum pratense L.	Fleumi i livadhët;
Medicago sativa L.	Jonxha;
Medicago × varia T. Martyn	Jonxha hibride e ranishtave;
Pisum sativum L.	Bizelja e zakonshme;
Raphanus sativus L. var. oleiformis Pers. rrepat ose rrënjoret tuberoze foragjere	
Trifolium repens	Tërfili i bardhë rrëshqanor;
Trifolium pratense L.	Tërfili i kuq/ i livadheve;

1.8 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit që i bashkëlidhet kërkesës për certifikim të farave foragjere dhe farave foragjere të përziera është sipas shtojcës V të këtij vendimi.

2. Kriteret e ruajtjes, marrja e mostrave dhe analiza e farës për certifikim

2.1 Farat foragjere duhet të mbahen në mjedise të përshtatshme, në të cilat, gjatë përpunimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit, sigurohen temperatura dhe lagështira optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknikë për farat foragjere dhe farat foragjere të përziera. Mjediset e përpunimit duhet të jenë të pajisura me impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin dhe paketimin e farave foragjere. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me aktmiratim higjieno-sanitar, të lëshuar nga strukturat vendore të shëndetit publik, si dhe me certifikatën DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim), të lëshuar nga subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi. Farat foragjere nuk duhet të mbahen në ruajtje më shumë se 3 (tre) vjet.

2.2 Fara foragjere dhe farat foragjere të përziera tregtohen si të tilla vetëm pasi të jenë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar. Gjatë përpunimit, farat foragjere mund të dezinfektohen e të peletohen me pesticide e lëndë kimike, ushqyese, kjo e shoqëruar me shënimin në etiketën përkatëse.

2.3 Furnizuesve të farave foragjere u lejohet që në mjediset e tyre të përpunojnë, të paketojnë dhe të etiketojnë fara foragjere edhe për furnizues të tjerë, të licencuar për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e farave foragjere.

2.4 Procesi i analizës laboratorike të farave foragjere për certifikim ushtrohet mbi:

a) lotin e farës, si një sasi e dhënë fare foragjere, e një riprodhimi dhe e një kategorie që ka pastërri varietore të caktuar;

b) mostrën, si një sasi fare e marrë në një ose në disa pika të lotit të farës;

c) kampionin fillestar, si një sasi fare foragjere që del nga përzierja e mostrave;

ç) kampionin mesatar si një pjesë e kampionit fillestar;

d) provën si një pjesë e kampionit mesatar, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën III të këtij vendimi.

2.5 Mostrat e farave për analizën e farave foragjere, për qëllim certifikimi, duhet të merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë të autorizuar nga ESHFF-ja, në përputhje me metodat teknike të përcaktuara me urdhër të ministrit.

2.6 Për ekzaminimin e farës foragjere për certifikim, mostrat duhet të nxirren nga lote homogjene. Pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre janë dhënë në shtojcën III të këtij vendimi.

IV. PROCEDURAT DHE METODAT E TESTIMIT TË VARIETETEVE QË REGJISTROHEN NË KATALOGUN KOMBËTAR

1. Procedurat dhe metodat e kryerjes së testimit

1.1 Testimi i një varieteti ka për qëllim kryerjen e provave zyrtare mbi farën për të verifikuar plotësimin e kërkesave për vlerat e kultivimit dhe përdorimit të tyre, për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet, me qëllim regjistrimin në Katalogun Kombëtar (KK).

1.2 Testimi i varietetit bëhet në kuadër të kërkesës së të interesuarit për regjistrimin e këtij varieteti në KK dhe kryhet nga ESHFF-ja ose subjekte publike ose private të autorizuar që veprojnë në fushën e bujqësisë në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” (në vijim “autoriteti testues”).

1.3 Aplikanti për regjistrim në KK të varieteteve ose hibrideve të reja paraqet:

a) kërkesë me shkrim pranë ESHFF-së;

b) skedën e karakteristikave për kultivarin apo hibridin që do të testohet;

c) rezultatet e provave të seleksionerit;

ç) fotografi të bimës apo të frytit;

d) sasinë e farës për mbjellje sipas normativave të miratuara me udhëzim të ministrit.

1.4 Procedura e testimit të varietetit, e cila kryhet nga autoriteti testues, përfshin:

a) zbatimin nga ESHFF-ja të metodikave të hartuara nga UPOV-i;

b) kryerjen e provave sipas metodikave të sipërcituara dhe ndjekjen e fazave të zhvillimit të bimëve;

c) përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar për ta paraqitur në Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar.



1.5 Provat për testimin e varieteteve apo hibrideve për vlerën e kultivimit dhe përdorimit kryhen sipas këtyre afateve:

- a) Për varietetet e krijuara në vend, për jo më pak se 2 (dy) vjet;
- b) Për varietetet ose hibridet e prodhuara në shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose në shtetet që kanë nënshkruar Konventën e UPOV-it, në rastet kur bëhet testimi, kryhet për 1 (një) deri 2 (dy) vjet;
- c) Për varietetet ose hibridet që janë prodhuar në vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Europian ose të Konventës së UPOV-it testimi kryhet në jo më pak se 2 (dy) vjet;
- ç) Për varietetet e farave foragjere shumëvjeçare, sipas kërkesave të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, testimi kryhet për 3 (tre) deri 4 (katër) vjet.

1.6 Provat e mostrave të farave foragjere, që hidhen në treg në bazë të kërkesave të këtij vendimi, duhet të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në pikat zonale të miratuara nga ministri.

1.7 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit, që i bashkëlidhet kërkesës për testim, janë sipas shtojcës VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

V. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohet Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF) dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA I

KUSHTET QË DUHET TË PËRMBUSHIN PARCELAT E FARAVE FORAGJERE

1. Parabima e parcelave të farës, nuk duhet të ketë qenë e papajtueshme me prodhimin e farave të specieve dhe varieteteve të bimëve foragjere. Fusha nuk duhet të ketë bimë që kanë mbirë nga farat e parabimës.

2. Kulturat foragjere duhet të jenë në përputhje me standardet e mëposhtme, në lidhje me distancat nga burimet fqinje të polenit, të cilat mund të shkaktojnë pllenim të huaj dhe të padëshirueshëm:

Bima	Distanca minimale në (m)
1	2
<i>Spp. Brassica, Phacelia tanacetifolia:</i>	
- për prodhimin e farës bazë	400 m
- për prodhim fare të certifikuar	200 m
Specie të varieteteve të tjera veç <i>Spp. Brassica, Phacelia tanacetifolia</i> si <i>Pisum sativum</i> , Varietetet e <i>Poa pratensis</i> /flokësi i livadheve të përmendura në pjesën e dytë të fjalisë së tretë të paragrafit 4:	200 m
- për prodhimin e farës të destinuar për shumëzim, fushat deri në dy hektarë;	100 m
- për prodhimin e farës të destinuar për shumëzim, fushat mbi dy hektarë;	
- për prodhimin e farës të destinuar për prodhimin e bimëve foragjere, fushat deri në dy hektarë;	100 m
- për prodhimin e farës të destinuar për prodhimin e bimëve foragjere, fushat mbi dy hektarë	50 m

Këto distanca mund të mos merren parasysh, në qoftë se ka mbrojtje të mjaftueshme nga çdo lloj pllenimi i huaj dhe i padëshirueshëm.

3. Bimët të llojeve të tjera, farat e të cilave dallohen me vështirësi nga farat e kulturave në një testim laboratorik, duhet të jenë në nivel sa më të ulët.

Në veçanti, të lashtat e llojeve *lolium* ose *x festulolium*, duhet të përputhet me kushtet e mëposhtme:

Numri i bimëve të një specie loliumi ose x festulolium, përveç bimëve të specieve që kultivohen, nuk duhet të kalojë:

- 1 (një) për 50 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës bazë”;
- 1 (një) për 10 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës së certifikuar”.

4. Kulturat foragjere duhet të kenë identitet dhe pastërti varietore të mjaftueshme. Në veçanti, kultura të tjera nga ato të specieve *Pisum sativum*, *Vicia faba*, var. *Brassica napus napobrassica*, *Brassica oleracea convar. acephala* ose të *Poa pratensis* duhet të jenë konform me standardet e mëposhtme:

Numri i bimëve të specieve, të cilat janë dukshëm të dallueshme dhe nuk bëjnë pjesë në këtë varietet nuk duhet të kalojë:

- 1(një) për 30 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës bazë”; dhe
- 1(një) për 10 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës së certifikuar”.

Në rastin e flokësit të livadheve (*Poa pratensis*), numri i bimëve të specieve, të cilat janë dukshëm të dallueshme dhe nuk bëjnë pjesë në këtë varietet nuk duhet të kalojë:

- 1 (një) për 20 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës bazë”; dhe
- 1 (një) për 10 m² në sipërfaqet për prodhimin e “farës së certifikuar”.

Në rastin e varieteteve, të cilat janë klasifikuar zyrtarisht si varietete të riprodhimit joseksual” (varietete apomictice uni-clonale), një numër i bimëve të njohura si jo të njëjta me varietetin, të cilat nuk i kalojnë 6 (gjashtë) për 10 m², mund të konsiderohen se i plotësojnë standardet për prodhimin e “farës së certifikuar”.

5. Organizmat e dëmshëm, të cilët ulin cilësinë e farës duhet të jenë në nivelin më të ulët të mundshëm.

6. Për plotësimin e standardeve të mësipërme ose kushteve të tjera, në rastin e “farës bazë”, duhet të bëhet ekzaminimi dhe inspektimi apo kontrolli zyrtar në fushë. Për “farën e certifikuar”, të kryhen inspektime apo kontrole zyrtare fushore.

Inspektimet apo kontrollet në fushë do të kryhen në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) Kushtet dhe faza e zhvillimit të bimëve duhet të lejojnë një ekzaminim të përshtatshëm;
- b) Duhet të kryhet të paktën një inspektim apo kontroll fushor;
- c) Madhësia, numri dhe shpërndarja e pjesëve të parcelës, që do të inspektohet apo kontrollohet,

me qëllim që të verifikohet respektimi i dispozitave të kësaj shtojce, duhet të përcaktohen në përputhje me metoda të përshtatshme.

SHTOJCA II KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË FARA

SEKSIONI I FARA E CERTIFIKUAR

1. Fara foragjere duhet të ketë identitet dhe pastërti të mjaftueshme varietore. Në veçanti, farat e specieve të renditura më poshtë duhet të plotësojnë edhe kërkesat në vijim:

a) Pastërtia varietore minimale duhet të jetë:

- *Poa pratensis*, varietetet e përmendura në pikën 4 të shtojcës I, *Brassica napus var. napobrassica* dhe *Brassica oleracea convar. Acephala* 98%;
- *Pisum sativu dhe, Vicia faba*: “fara e certifikuar” e riprodhimit të parë - 99%, “fara e certifikuar” e riprodhimit të dytë 98%.

2. Pastërtia varietore minimale duhet të kontrollohet nëpërmjet kontrolleve nga autoriteti certifikues, të kryera në fushë në përputhje me kushtet e përcaktuara në shtojcën I.

3. Fara duhet jetë në përputhje me standardet dhe kushtet e tjera të përcaktuara në germat A dhe B në vijim për sa i përket fuqisë mbirëse, pastërtisë analitike dhe përmbajtjes së farërave të llojeve bimore të tjera, duke përfshirë praninë e farave të hidhura në varietetet e ëmblla të *spp. Lupinus*.



A. Tabela

Speciet	Fuqia mbirëse		Pastërtia varjetore e analizuar								Përmbajtja maksimale e farave të bimëve të specieve të tjera në një mostër me peshë të përcaktuar në kolonën 4 të shtojcës III (totali për kolon)			Kushtet për sa i takon përmbajtjes së farave të Spp. Lupinus me ngjyrë tjetër dhe të farave të hidhura të lupinit
	Fuqia mbirëse minimale (% e farës së pastër)	Përmbajtja maksimale e farave të forta (% e farave të pastra)	Pastërtia minimale e analizuar (% sipas peshës)	Përmbajtja maksimale e farave të bimëve të specieve të tjera (në % sipas peshës)							Avena fatua, Avena Sterilis	Spp. Kuskutës	Spp. Rumex veç Rumex acetosella dhe Rumex maritimus	
				Totali	Një specie e vetme	Elytrigia repens	Alopecurus myosuroides	Spp. Melilotus	Raphanus raphanistrum	Sinapis arvensis				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Graminoret														
Barimëza bisht qeni	75 (a)		90	2	1	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	2 (n)	
Barimëza Bisht qeni kokë kafenjta	75 (a)		90	2	1	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	2 (n)	
Barimëza helika kokëkuqe	80 (a)		90	2	1	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	2 (n)	
Barimëza bisht qeni zvarritës	75 (a)		90	2	1	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	2 (n)	
Bisht dhelpra e livadhit/ Pungaca e livadhit	70 (a)		75	2.5	1 (f)	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)	
Arrenatera e lartë (tip tërshëre)	75 (a)		90	3	1 (f)	0.5	0.3				0 (g)	0 (j) (k)	5 (n)	
Bromusi	75 (a)		97	1.5	1	0.5	0.3				0 (g)	0 (j) (k)	10 (n)	
Bromusi i Alaskës	75 (a)		97	1.5	1	0.5	0.3				0 (g)	0 (j) (k)	10 (n)	

Krisja ose gram	70 (a)		90	2	1	0.3	0.3				0 (g)	0 (j) (k)	2
Telishi lëmshor	80 (a)		90	1.5	1	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Bishtpelëza si kallam	80 (a)		95	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Bishtpelëza e dhënëve me gjethe të lëmuara	75 (a)		85	2	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Bishtpelëza e deleve	75 (a)		85	2	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Bishtpelëza e livadhit	80 (a)		95	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Bishtpelëza e kuqe	75 (a)		90	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Bishtpelëza e drunjtë	75 (a)		85	2	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Festukë x Lolium	75 (a)		96	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Egjra shumëlulëshe	75 (a)		96	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Egjra shumë vjeçare	80 (a)		96	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Lolium x boucheanum	75 (a)		96	1.5	1	0.5	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Kokëmadhja Falari ujqor	75 (a)		96	1.5	1	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	5
Fleumi me nyje ose nyjqor	80 (a)		96	1.5	1	0.3	0.3				0	0 (k)	5
Fleumi i livadhit	80 (a)		96	1.5	1	0.3	0.3				0	0 (k)	5
Flokësi njëvjeçar	75 (a)		85	2 (c)	1 (c)	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	5 (n)
Flokësi i pyjeve	75 (a)		85	2 (c)	1 (c)	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	2 (n)
Flokësi i	75 (a)		85	2 (c)	1 (c)	0.3	0.3				0	0 (j) (k)	2 (n)



ligatinave moçalore													
Flokësi i livadheve	75 (a)		85	2 (c)	1 (c)	0.3	0.3			0	0 (j) (k)	2 (n)	
Flokësi i zakonshëm	75 (a)		85	2 (c)	1 (c)	0.3	0.3			0	0 (j) (k)	2 (n)	
Triseta e zbetë	70 (a)		75	3	1 (f)	0.3	0.3			0 (h)	0 (j) (k)	2 (n)	
Bishtajoret										0	0 (j) (k)		
Bar qerbash	60	40	97	2	1.5		0.3			0	0 (l) (m)	10 (n)	
Sulla	75 (a) (b)	30	95	2.5	1		0.3			0	0 (k)	5	
Tërfili me brirë ose këmbë pule	75 (a) (b)	40	95	1.8 (d)	1 (d)		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Lupini i bardhë	80 (a) (b)	20	98	0.5 (e)	0.3 (e)		0.3			0 (i)	0 (j)	5 (n)	(o) (p)
Lupini gjethengushtë	75 (a) (b)	20	98	0.5 (e)	0.3 (e)		0.3			0 (i)	0 (j)	5 (n)	(o) (p)
Lupini i verdhë	80 (a) (b)	20	98	0.5 (e)	0.3 (e)		0.3			0 (i)	0 (j)	5 (n)	(o) (p)
Jonxha lupulinë	80 (a) (b)	20	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Jonxha	80 (a) (b)	40	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Jonxha hibride e ranishteve	80 (a) (b)	40	97	2.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Sainfoin	75 (a) (b)	20	95	2.5	1		0.3			0	0 (j)	5	
Bizelja	80 (a)		98	0.5	0.3		0.3			0	0 (j)	5(n)	
Tërfili Aleksandrin	80 (a) (b)	20	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Tërfili hibrid	80 (a) (b)	20	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Tërfili i kuqërremtë ose i purpurt	75 (a) (b)	20	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Tërfili i kuq/ i livadheve	80 (a) (b)	20	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	
Tërfili i bardhë	80 (a) (b)	40	97	1.5	1		0.3			0	0 (l) (m)	10	

rrëshqanor													
Tërfilli persian, i përmbystë	80 (a) (b)	20	97	1.5	1			0.3			0	0 (l) (m)	10
Trëndelina	80 (a)		95	1	0.5			0.3			0	0 (j)	5
Batha	80 (a) (b)	5	98	0.5	0.3			0.3			0	0 (j)	5 (n)
Grashina e Panonisë	85 (a) (b)	20	98	1 (e)	0.5 (e)			0.3			0 (i)	0 (j)	5 (n)
Koçkulla	85 (a) (b)	20	98	1 (e)	0.5 (e)			0.3			0 (i)	0 (j)	5 (n)
Grashina me qime	85 (a) (b)	20	98	1 (e)	0.5 (e)			0.3			0 (i)	0 (j)	5 (n)
Specie të tjera													
Sinapi	80 (a)		98	1	0.5			0.3	0.3		0	0 (j) (k)	5
Lakra e zakonshme	75 (a)		98	1	0.5			0.3	0.3		0	0 (j) (k)	10
Kambanorja blu	80 (a)		96	1	0.5						0	0 (j) (k)	
Rrepat ose rrënjoret tuberoze foragjere	80 (a)		97	1	0.5			0.3	0.3		0	0 (j)	5



B. Standarde ose kushte të tjera të zbatueshme, kur referimi është bërë për farat në tabelën sipas pikës I (2) (A) të kësaj shtojce

a) Të gjitha farat e reja dhe të shëndetshme, të cilat nuk mbijnë pasi është bërë një paratrajtim, do të konsiderohen si fara që kanë mbirë.

b) Deri në sasinë maksimale, farat e forta të pranishme duhet të konsiderohen si fara të afta për të mbirë.

c) Një maksimum prej 0,8% ndaj peshës së farave të specieve të tjera Poa, nuk duhet të konsiderohet si një papastërti.

d) Një maksimum prej 1% ndaj peshës së farave të trifolium pratense, nuk do të konsiderohet si një papastërti.

e) Maksimumi prej 0,5% ndaj peshës së farave të *lupinus albus*, *lupinus angustifolius*, *lupinus luteus*, *pisum sativum*, *vicia faba*, *vicia pannonica*, *vicia sativa*, *vicia villosa* në një specie tjetër, përkatëse nuk do të konsiderohet si një papastërti.

f) Përçindja maksimale e përcaktuar ndaj peshës së farave të një specie të vetme, nuk do të zbatohet për farërat e spp. Poa.

g) Një maksimum prej dy fara *Avena fatua* dhe *Avena sterilis*, në një mostër të një peshe të caktuar, nuk do të konsiderohet si një papastërti, kur një mostër e dytë të së njëjtës peshë është e pastër nga çdo farë e këtyre specieve.

h) Prania e një fare *Avena fatua* dhe *Avena sterilis* në një mostër të peshës së caktuar, nuk do të konsiderohet si një papastërti, ku një mostër e dytë sa dy herë pesha e caktuar është e pastër nga çdo farë e këtyre specieve.

i) Përcaktimi i numrit të farave *avena fatua* dhe *avena sterilis* nuk duhet të kryhet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në kolonën 12.

j) Përcaktimi i farave të spp. Kuskutës, duke i numëruar, nuk mund të kryhet nëse nuk ka dyshime për plotësimin e kushteve të vendosura në kolonën 13.

k) Prania e një fare të spp. kuskutës në një mostër me një peshë të përcaktuar, nuk duhet të konsiderohet si një papastërti kur një mostër e dytë me peshë të njëjtë është pa asnjë farë të spp. Kuskutës.

l) Pesha e mostrës për përcaktimin e numrit të farave të spp. kuskutës, duhet sa dyfishi i peshës së specifikuar në kolonën 4 të shtojcës III për speciet përkatëse;

m) Prania e një fare të spp. kuskutës në një mostër me peshë të caktuar, nuk mund të konsiderohet si papastërti, kur një mostër e dytë me peshë dyfishin e peshës së përcaktuar është pa asnjë farë të spp. Kuskutës.

n) Përcaktimi i farave të spp. rumex, ndryshe *Rumex acetosella* dhe *Rumex maritimus*, duke i numëruar nuk mund të kryhet përveç kur ka dyshime mbi plotësimin e kushteve të përcaktuara në kolonën 14.

o) Përçindja sipas numrit të farave të sp. lupinuss me ngjyrë tjetër, nuk duhet të kalojë:

- në lupinin e hidhur, 2%;

- në spp. e tjera përveç lupinit të hidhur, 1%.

p) Përçindja e numrit të farave të hidhura në varietetet e sp. Lupinit, nuk duhet të kalojë 2.5%.

SEKSIONI II FARAT BAZË

Në bazë të dispozitave të mëposhtme, për “farat bazë” duhen zbatuar kërkesat e parashikuara në seksionin I të kësaj shtojce:

1. Farat e varieteteve *Pisum sativum*, *Brassica napus var. napobrassica*, *Brassica oleracea convar. acephala*, *Vicia faba* dhe varietete të *Poa pratensis*, duhet të përputhen me standardet e mëposhtme ose kushte të tjera:

- pastërtia minimale varietore duhet të jetë 99.7%. Pastërtia minimale varietore duhet të shqyrtohet nga kontrollet fushore të kryera në përputhje me kushtet e përcaktuara në shtojcën I.

2. Fara duhet të plotësojë standardet që vijojnë:

A. Tabela

Speciet	Totali (% sipas peshës)	Një specie e vetme	Spp. Rumex veç Rumex acetosella dhe Rumex maritimus	Elytrigia repens	Alopecurus myosuroides	Spp. Melilotus	Kushte ose standarde të tjera
1	2	3	4	5	6	7	8
Graminore							
Barimëza bisht qeni	0.3	20	1	1	1		(j)
Barimëza bisht qeni kokëkafenjta	0.3	20	1	1	1		(j)
Barimëza helika kokëkuqe	0.3	20	1	1	1		(j)
Barimëza bisht qeni zvarritës	0.3	20	1	1	1		(j)
Bisht dhelpra e livadhit/ pungaca e livadhit	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Arrenatera e lartë (tip tërshëre)	0.3	20 (a)	2	5	5		(i) (j)
Bromusi	0.4	20	5	5	5		(j)
Bromusi i Alaskës	0.4	20	5	5	5		(j)
Krisja ose grëmi	0.3	20 (a)	1	1	1		(j)
Telishi lëmshor	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Bishtpelëza si kallam	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Bishtpelëza e dhënëve me gjethe të lëmuara	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Bishtpelëza e deleve	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Bishtpelëza e livadhit	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Bishtpelëza e kuqe	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Bishtpelëza e drunjte	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Festukë x Lolium	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Egjëra shumëlulëshe	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Egjëra shumëvjeçare	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Lolium x boucheanum	0.3	20 (a)	2	5	5		(j)
Kokëmadhja Falari ujor	0.3	20	2	5	5		(j)
Fleumi me nyje ose nyjor	0.3	20	2	1	1		(j)
Fleumi i livadhit	0.3	20	2	1	1		(j)
Flokëzi njëvjeçar	0.3	20 (b)	1	1	1		(f) (j)
Flokëzi i pyjeve	0.3	20 (b)	1	1	1		(f) (j)
Flokëzi i ligatinave	0.3	20 (b)	1	1	1		(f) (j)



moçalore							
Flokëzi i livadheve	0.3	20 (b)	1	1	1		(f) (j)
Flokëzi i zakonshëm	0.3	20 (b)	1	1	1		(f) (j)
Triseta e zbetë	0.3	20 (c)	1	1	1		(i) (j)
Bishtajoret							
Bar qerbash	0.3	20	2			0 (e)	(j)
Sulla	0.3	20	2			0 (e)	(j)
Tërfile me brirë ose këmbëpule	0.3	20	3			0 (e)	(g) (j)
Lupini i bardhë	0.3	20	2			0 (d)	(h) (k)
Lupini gjethengushtë	0.3	20	2			0 (d)	(h) (k)
Lupini i verdhë	0.3	20	2			0 (d)	(h) (k)
Jonxha lupulinë	0.3	20	5			0 (e)	(j)
Jonxha	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Jonxha hibride e ranishtave	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Sainfoin	0.3	20	2			0 (d)	
Bizelja	0.3	20	2			0 (d)	
Tërfile Aleksandërin	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Tërfile hibrid	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Tërfile i kuqërremtë ose i purpurt	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Tërfile i kuq/ i livadheve	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Tërfile i bardhë rrëshqanor	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Tërfile Persian, i përmbystë	0.3	20	3			0 (e)	(j)
Trëndelina	0.3	20	2			0 (d)	
Batha	0.3	20	2			0 (d)	
Grashina e Panonisë	0.3	20	2			0 (d)	(h)
Koçkulla	0.3	20	2			0 (d)	(h)
Grashina me qime	0.3	20	2			0 (d)	(h)
Specie të tjera							
Sinapi	0.3	20	2				(j)
Lakra e zakonshme	0.3	20	3				(j)
Kambanorja blu	0.3	20					
Rrepat ose rrënjoret tuberoze foragjere	0.3	20	2				

B. Standardet ose kushtet e tjera të aplikueshme kur referimi për farat është bërë në tabelën sipas seksionit II (2) (A) të kësaj shtojce:

- Totali prej maksimumi 80 fara të *spp. Poa*, nuk do të konsiderohet si papastërti.
- Kushti i përcaktuar në kolonën 3, nuk është i aplikueshëm për fara të *spp. Poa*. Përmbajtja maksimale e farave të *spp. të tjera Poa*, përveç specieve që kontrollohen, nuk duhet të kalojë një farë në një mostër prej 500 farash.
- Totali prej 20 fara e *spp. Poa*, nuk do të konsiderohet si një papastërti.

d) Përcaktimi i numrit të farave të *spp. Melilotus*, nuk duhet të kryhet përveç se kur ka dyshime mbi plotësimin e kushteve të përcaktuara në kolonën 7.

e) Prania e një fare të *spp. Melilotus* në një mostër me peshë të caktuar, nuk mund të konsiderohet si papastërti kur një mostër e dytë me peshë dyfishin e peshës së përcaktuar është pa asnjë farë të *spp. Melilotus*.

f) Kushti (c) përcaktuar në seksionin I (2) të kësaj shtojce nuk është i aplikueshëm.

g) Kushti (d) përcaktuar në seksionin I (2) të kësaj shtojce nuk është i aplikueshëm.

h) Kushti (e) përcaktuar në seksionin I (2) të kësaj shtojce nuk është i aplikueshëm.

i) Kushti (f) përcaktuar në seksionin I (2) të kësaj shtojce nuk është i aplikueshëm;

j) Kushtet (k) dhe (m) të parashikuar në seksionin I (2) të kësaj shtojce nuk janë të zbatueshme.

k) Numri i farave të hidhura në varietetet e *spp. Lupinus* nuk duhet të kalojë 1%.

SHTOJCA III PESHA E LOTIT DHE E MOSTRËS

Speciet	Pesha maksimale e një loti në (ton)	Pesha minimale e një mostre që merret nga një lot (gram)	Pesha e mostrës për përcaktimet në numër, parashikuar në kolona 12 deri 14 të Shtojcës II (I) (2) (A) dhe kolonat 3 deri 7 të Shtojcës II (II) (2) (A) (gram)
1	2	3	4
Graminoret			
Barimëza bisht qeni	10	50	5
Barimëza bisht qeni kokëkafenjta	10	50	5
Barimëza helika kokëkuqe	10	50	5
Barimëza bisht qeni zvarritës	10	50	5
Bisht dhelpra e livadhit/ Pungaca e livadhit	10	100	30
Arrenatera e lartë (tip tërshëre)	10	200	80
Bromusi	10	200	200
Bromusi i Alaskës	10	200	200
Krisja ose grëmi	10	50	5
Telishi lëmshor	10	100	30
Bishtpelëza si kallam	10	100	50
Bishtpelëza e dhenve me gjethe të lëmuara	10	100	30
Bishtpelëza e deleve	10	100	30
Bishtpelëza e livadhit	10	100	50
Bishtpelëza e kuqe	10	100	30
Bishtpelëza e drunjtë	10	100	30
Festukë x Lolium	10	200	60
Egjëra shumëlulëshe	10	200	60
Egjëra shumëvjeçare	10	200	60
Lolium x boucheanum	10	200	60
Kokëmadhja fjalari uJOR	10	100	50
Fleumi me nyje ose nyjor	10	50	10
Fleumi i livadhit	10	50	10
Flokësi njëvjeçar	10	50	10
Flokësi i pyjeve	10	50	5



Flokësi i ligatinave moçalore	10	50	5
Flokësi i livadheve	10	50	5
Flokësi i zakonshëm	10	50	5
Trisetë e zbetë	10	50	5
Bishtajoret			
Bar qerbashi	10	250	200
Sulla			
Frut	10	1000	300
Farë	10	400	120
Tërfili me brirë ose këmbë pule	10	200	30
Lupini i bardhë	30	1000	1000
Lupini gjethengushtë	30	1000	1000
Lupini i verdhë	30	1000	1000
Jonxha lupulinë	10	300	50
Jonxha	10	300	50
Jonxha hibride e ranishtave	10	300	50
Sainfoin			
Frut	10	600	600
Farë	10	400	400
Bizelja	30	1000	1000
Tërfili aleksandrin	10	400	60
Tërfili hibrid	10	200	20
Tërfili i kuqërremtë ose i purpurt	10	500	80
Tërfili i kuq/ i livadheve	10	300	50
Tërfili i bardhë rrëshqanor	10	200	20
Tërfili persian, i përmbystë	10	200	20
Trëndelina	10	500	450
Batha	30	1000	1000
Grashina e Panonisë	30	1000	1000
Koçkulla	30	1000	1000
Grashina me qime	30	1000	1000
Specie të tjera			
Sinapi	10	200	100
Lakra e zakonshme	10	200	100
Kambanorja blu	10	300	40
Rrepat ose rrënjoret tuberoze foragjere	10	300	300

SHTOJCA IV ETIKETIMI

A. ETIKETA ZYRTARE

I. Informacioni i kërkuar

a) Për “farën bazë” dhe “farën e certifikuar”:

1. Autoriteti certifikues ose inicialet e tij;
2. Numri i serisë së etiketës;
3. Numrin e referencës për lotin, si dhe datën e lëshimit të etiketës;
4. Specia, treguar të paktën nën emrin e saj botanik, i cili mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emra të autorëve, me germa latine. Në rastin e kryqëzimit me *X festulolium* duhet të tregohen emrat e specieve brenda gjinive *festuca* dhe *lolium*;
5. Varieteti të tregohet në germa latine;
6. Kategoria;
7. Vendi i prodhimit;
8. Deklarimi i peshës;
9. Kur janë përdorur pesticide të granuluar ose substanca të tjera të peletuara, duhet të deklarohet edhe natyra e pesticideve;
10. Kur fuqia mbirëse është rianalizuar, jepen fjalët “rianalizuar ... (muaji dhe viti)” dhe shërbimi përgjegjës për rianalizimin të tilla.
11. Përmasat minimale të etiketës 110 × 67 mm.

b) Për farat e përziara:

Përveç sa më sipër në germën (a) kërkohet edhe:

1. Etiketa duhet të përmbajë shënimin: “Përzierje farash për ... (qëllimi i përdorimit)”;
2. Përqindja sipas peshës e komponentëve të ndryshëm sipas specieve dhe, kur është e përshtatshme me variete, duhen treguar të paktën me germa latine, por është e mjaftueshme edhe dhënia e emrit të përzierjeve në qoftë se përqindja sipas peshës është treguar me shkrim për blerësin dhe është e regjistruar zyrtarisht. Në rastin e kryqëzimit me *X festulolium* duhet të tregohen emrat e specieve brenda gjinive *festuca* dhe *lolium*.

c) Ngjyra e etiketës dhe dokumenti brenda paketës

Etiketa duhet të jetë në ngjyrë të bardhë me një vijë ngjyrë vjollcë diagonale për “farat para bazë”, me ngjyrë të bardhë për “farat bazë”, me ngjyrë blu për “farat e certifikuara” dhe farat e certifikuara të riprodhimit të parë, me ngjyrë të kuqe për farat e certifikuara të riprodhimit të dytë dhe me ngjyrë jeshile për farat e përziara. Dokumenti duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën. Dokumenti nuk është i domosdoshëm nëse kërkesat janë të printuara me bojë të pashlyeshme mbi paketim, ose në qoftë se përdoret një etiketë ngjyëse ose një etiketë e përbërë nga një material rezistent.



SHTOJCA V
FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT QË I BASHKËNGJITET KËRKESËS PËR
CERTIFIKIM

Kërkesë për aplikim

Drejtuar: Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF)

Tiranë

Për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, parashikuar në neni 12 të ligjit nr. 10
416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri:
2. Adresa:
3. Emërtimi i subjektit dhe adresa:
4. Nr. NUIS: (nga QKR)

Të dhëna për përfaqësuesin e autorizuar:

1. Emri e mbiemri:
2. Adresa:
3. Nr. i personal i identifikimit:

Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	*
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Afati kohor i tregtimit:

Furnizuesi:

Emri, mbiemri, firma dhe vula enti dhe data

ENTI SHETËTOR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL MBI CAKTIMIN E NGASTRËS SË FARËS

Mbahet sot, më datë, në fermën/ekonominë, fshati, komuna....., qarku....., për caktimin e ngastrës së farës të kulturës, kultivari....., (hibridi)....., që do të mbillet me farë të riprodhimit, gjatë vitit..... ..

Kjo ngastër fare caktohet në ekonominë e, me sip.ha, në kushte (mbi ose nën ujë) dhe me distancë izolimi në hapësirë nga kultivarët e tjerë prej ml.

Për realizimin e prodhimit të farës prej kv, furnizuesi merr përsipër të zbatojë këto hallka të teknologjisë:

1.
2.
3.
4.
5.
6.

Procesverbali mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti i farave të DRB-së dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

FURNIZUESI SPEC. FAR. DRB

SPEC. I CERTIFIKIMIT ZYRTAR ESHFF



ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

CERTIFIKATË E ORIGINËS

PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND
(Bazuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, neni 16/c)

Në mbështetje të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” neni 16/c”, nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore lëshoj këtë certifikatë – origjine, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me të dhënat e mëposhtme:

Specia
Varieteti
Riprodhimi
Numri referencës
Numri i serisë etiketës zyrtare
Viti i prodhimit
Vend origjina

FURNIZUESI

.....
(firma, vula)

Tiranë, më.....

ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI CERTIFIKIMIT ZYRTAR

AKTKONTROLI

PËR PARCELËN E FARËS

(Bazuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, neni 16/a “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”).

I mbajtur sot, më datë, në parcelat e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit z..... rrethi, komuna, parcela (vendndodhja)..... mbi zbatimin e teknologjisë për prodhimin e farës specia kultivari....., riprodhimi....., të mbjella në një sipërfaqe prej ha.

Nga kontrolli zyrtar rezultoi se janë zbatuar këto kërkesa teknike të përcaktuara;

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Ky aktkontroll mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti farërave të DRB-së, dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit zyrtar pranë ESHFF-së.

FURNIZUESI

SPEC. FAR. DRB-së

SPEC. I CERTIFIKIMIT ZYRTAR (ESHFF)



AKTAPROBIMI

PËR NGASTRËN E PRODHIMIT TË FARËS (Bazuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011, neni 16, pika 1/a)

Sot, më datë prej specialistëve të sektorit të certifikimit zyrtar të E.SH.F.F .z....., u bë aprorimi fushor i ngastrës së farës (nr. ose emri.....) në fermën/ekonominë e furnizuesit z....., fshati, komuna

1. Nga të dhënat cilësore të farës, rezulton:

Ngastra është mbjellë me farë specia,, kultivari.....
Riprodhimi; sipërfaqjaha, dokumenti i origjinës.....

.....

2. Mbas verifikimit del se:

- Është siguruar izolimim.
- Është zbatuar teknologjia, sipërfaqja e vlefshme për farëha,
Kultivari (hibridi), riprodhimi, sasia e farës që parashikohet të merretkv, kategoria

3. Gjendja e zhvillimit të bimëve në çastin e aproimit paraqitet:

.....
.....
.....

4. Treguesit e aproimit fushor:

Pastërtia varietore%	(.....)
Pastërtia nga barërat e këqija%	(.....)
Prekjet nga sëmundjet virusale%	(.....)
Prekjet nga sëmundjet kërpudhore%	(.....)
a)		(.....)
b)		(.....)
c) Dëmtime nga dëmtuesit		(.....)

5. Detyrimet e furnizuesit për trajtimin deri në tregtim:

.....
.....
.....
.....

FURNIZUESI

GRUPI I APROBIMIT

..... () () ()

DEKLARATË KONFORMITETI

Unë i nënshkruari.....përfaqësues i subjektit:....., me NUIS.....me nr. licencë nr., sot më datë, deklaroj në përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor..... i prodhuar nga ana ime është konform këtij specifikimi teknik:

1. Është i shoqëruar me certifikatën e origjinës nr., datë
2. Është i shoqëruar me certifikatën fitosanitare nr., datë
3. Është i shoqëruar me rezultatin e analizës nr., datë
4. Specia
5. Varieteti
6. Riprodhimi
7. Cilësia
8. Është i ambalazhuar në, me peshë
9. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara nga dhe i përket lotit nr.

Lëshoj këtë deklaratë konfirmiteti komform ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “ Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 11, 12 dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

DEKLARUESI

(....., më datë))

ETIKETA E PRODHUESIT

Emri i subjektit furnizues
Numri NUIS
Numri i licencës
Vendi i prodhimit
Specia
Fuqia mbirëse
Data e analizës
Trajtimi (emri i pesticidit)
Data e paketimit
Pesha e njësisë së paketimit



ETIKETA E PRODHUESIT
(Për farat foragjere të përziëra)

Emri i subjektit furnizuesi
Numri NUIS
Numri i licencës
Vendi i prodhimit
Speciet (përbërësit)
Raporti i përbërësve në %
Fuqia mbirëse
Data e analizës
Trajtimi (emri i pesticidit)
Data e paketimit
Pesha e njësisë së paketimit

ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

ETIKETA ZYRTARE
(për fara foragjere)

Nr. i serisë
Specia
Variateti
Kategoria
Nr. lotit
Emri i subjektit prodhues
Vendi i prodhimit
Pesha neto e pakos
Data
Rianalizuar: PO / JO Data rianalizimit:.....
Trajtuar me pesticide ose substanca të tjera kimike: PO / JO
Emri i pesticidit ose i substancës:.....

ENTI SHITËTËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

ETIKETA ZYRTARE
(për farat foragjere të përziera)

Nr. i serisë

Përqindja sipas komponentëve

Speciet

Varietetet

Kategoria

Nr. lotit

Emri i subjektit prodhues

Vendi i prodhimit

Pesha neto e pakos

Data

Rianalizuar: PO / JO Data rianalizimit:

Trajtuar me pesticide ose substanca të tjera kimike: PO / JO

Emri i pesticidit ose i substancës:.....



ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL
MBI VERIFIKIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, DOKUMENTACIONIT DHE
KONTROLLIN E CILËSISË SË FARËS

Në zbatim të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, mes specialistëve të certifikimit zyrtar Z.....dhe furnizuesit.....

Sot më datë, mbahet ky procesverbal, për verifikimin e treguesve cilësor dhe dokumentacionin për farën e prodhuar si vijon:

1. Furnizuesi, ka prodhuar farë të species me këto tregues:

- a) Varieteti
- b) Riprodhimi
- c) Viti i prodhimit
- d) Kontingjenti
- e) Nr. i lotit
- f) Etiketa me nr. serie

Dokumente që disponon:

- a) Certifikatë origjine nr....., datë.....
- b) Certifikatë fitosanitare nr....., datë.....
- c) Certifikatë analiza nr....., datë.....
- d) Certifikatë OECD nr....., datë.....
- e) Akt aprobimi nr....., datë.....
- f) Deklaratë konfirmiteti nr....., datë.....
- g) Procesverb. e kontrollit nr., datë.....,

Nga verifikimit i dokumenteve, si dhe nga rezultatet e analizave laboratorike rezulton se fara është e prodhuar në përputhje me specifikimet teknike. Prandaj duhet të pajiset me certifikatë zyrtare pasi subjekti të shlyej tarifën e certifikimit në shumën lekë.

FURNIZUESI

.....

SPECIALISTËT E CERTIFIKIMIT ZYRTAR

(.....) (.....)

MINISTRIA E BUJQËSISË USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
LABORATORI QENDROR I TESTIMIT TË FARAVE

Vula e laboratorit

FLETË ANALIZA E LOTIT TË FARËS

E LËSHUAR PËR APLIKANTIN PA PËRGJEGJËSINË E LABORATORIT				
Emri i aplikantit				
Specia	Kultivari	Kategoria	Pesha e lotit	etj.

INFORMACION

Laboratori i testimit	Shtetëror
Mostra e sjellë nga	Zyrtare
Nr. i lotit Natyra e certifikatës	
Vula e lotit	

Nr. i mbajtësve	Data e mostrimit	Data e pranimit	Data e testimit	Numri i testit

REZULTATI I ANALIZËS

Emri shkencor i species

Pastërtia			Nr. ditëve të testit	Mbirja					Lagështia %
% në peshë				ne %					
Farë e pastër	Lëndë inerte	Fara të tjera		Filiza normal	Fara të forta	Fara të freskëta	Fara anormale	Fara të vdekura	

Lloji i lëndës inerte.....

Fara të tjera

Përgjegjës i laboratorit



MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE AUTORITETI CERTIFIKUES

CERTIFIKATË ZYRTARE

PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND

/ FARËRA /

NR. _____, DATË _____.

Në mbështetje të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimorë”, neni 17 dhe 18, sektori i certifikimit zyrtar, pasi administroi dokumentacionin teknik të përcaktuar në nenin 15 dhe 16 të këtij ligji, dhe e vlerësoi atë të rregullt, lëshon këtë certifikatë zyrtare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, farë foragjere të prodhuar në vend, me të cilën konfirmon se:

Loti i farave të përziara prodhuar nga furnizuesi _____, sipas procedurave teknike të përcaktuara, është pajisur me etiketën zyrtare të lëshuar nga ESHFF dhe ka të dhënat që vijon:

Speciet
Varietetet në %
Kodi furnizuesit
Pesha e lotit
Lloji i njësisë së paketimit
Pesha e njësisë së paketimit
Numri i serisë të etiketës zyrtare
Numri i analizës kontrollit, ESHFF
Ngjyra e etiketës zyrtare

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PËRGJEGJËSI

Tiranë më

SHTOJCA VI
DOKUMENTACIONI I TESTIMIT TË FARAVE FORAGJERE

KËRKESË

ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

PËR REGJISTRIMIN E VARIETETIT/ SPECIES OSE HIBRIDIT.....

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e krijuesit/prodhuesit/importuesit, kërkoj regjistrimin e varieteteve/specieve ose hibridit sipas kërkesave të ligjit nr. 10 416 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”. (varietetit/specia ose hibridi _____).

Varieteti/hibridi rrjedh _____ (përmend prindërit që janë kryqëzuar ose sisteme të tjera të krijimit të tij). Në rastin e hibridit trego formulën e saktë duke theksuar nëse bëhet fjalë ose jo për hibride me formulë të thjeshtë.

Institucioni (ferma/ekonomia) ku mbahet varieteti i pastër ndodhet në qarkun _____, komunën _____ (ose bashkinë) _____ fshatin _____ dhe nëse është importuar, ardhur nga _____ (shteti).

Unë i nënshkruari _____ deklaroj se për këtë varietet është /nuk është paraqitur, kërkesa për regjistrimin e tij në vendet e BE-së ose vende të tjera që zbatojnë skemat e testimit të cilat përputhen me kërkesat e këtij vendimi. Në rast se është paraqitur kërkesë për regjistrim, për varietetet ose hibridet e importuara përmend shtetin ku është aplikuar për regjistrim. (shteti: _____).

Bashkëngjitur do të gjeni:

- a) Përshkrimin e varietetit ose hibridit në skedën përkatëse;
- b) Riprodhime fotografike ose fotografi të bimës ose pjesëve të saj që shërbejnë për identifikimin e saktë të varietetit/hibridit;
- c) Rezultatet e provave eksperimentale të kryera në vendin tonë ose jashtë tij.

KËRKUESI (ADRESA) _____

Firma _____

Data _____

SASITË E KAMPIONIT TË FARËS PËR PROVA PËR TESTIM

A) Kultura bujqësore (foragjere):

1. Leguminoze shumëvjeçare 2 kg farë për 2 vjet rresht:
2. Leguminoze njëvjeçare 2 kg farë për 2 vjet rresht + 100 bishtaja për bizelen foragjere:
3. Graminoret 2 kg farë për 2 vjet rresht:
4. Kolza 15 kg farë për 2 vjet rresht:
5. Soja 5 kg farë për 2 vjet rresht:



SHTOJCA VII
BIMËT FORAGJERE PËR PRODHIM FARASH

Emërtimi latinisht	Emërtimi shqip
a) Poaceae (Gramineae)	Graminoret
Agrostis canina L.	Barimëza bisht qeni
Agrostis capillaris L.	Barimëza Bisht qen, kokë kafenjta
Agrostis gigantea Roth	Barimëza helika kokëkuqe
Agrostis stolonifera L.	Barimëza bisht qeni zvarritës
Alopecurus pratensis L.	Pungaca e livadhit
Arrhenatherum elatius	Tërshërë e lartë shumëvjeçare
Bromus catharticus	Bromusi
Bromus sitchensis Trin	Bromusi i Alaskës
Cynodon dactylon	Krisja ose grëmi
Dactylis glomerata	Telishi lëmshor
Festuca arundinacea Schreber	Bishtpelëza si kallam
Festuca filiformis	Bishtpelëza e dhënëve me gjethe të lëmuara
Festuca ovina	Bishtpelëza e deleve
Festuca pratensis	Bishtpelëza e livadhit
Festuca rubra	Bishtpelëza e kuqe
Festuca trachyphylla	Bishtpelëza e drunjte
Lolium multiflorum	Egjëra shumëlulëshe
Lolium perenne	Egjëra shumëvjeçare
Phalaris aquatica L.	Kokëmadhja falari uJOR
Phleum nodosum L.	Fleumi me nyje ose nyjor
Phleum pratense L.	Fleumi i livadhit
Poa annua L.	Flokësi njëvjeçar
Poa nemoralis L.	Flokësi i pyjeve
Poa palustris L.	Flokësi i ligatinave moçalore
Poa pratensis L.	Flokësi i livadheve
Poa trivialis L.	Flokësi i zakonshëm
Trisetum flavescens (L.) P. Beauv.	Triseta e zbetë
b) Fabaceae (Leguminosae)	Bishtajoret
Galega orientalis Lam.	Bar qerbashi
Hedysarum coronarium L.	Sulla
Lotus corniculatus L.	Tërfili me brirë ose këmbë pule
Lupinus albus L.	Lupini i bardhë
Lupinus angustifolius L.	Lupini gjethengushtë
Lupinus luteus L.	Lupini i verdhë
Medicago lupulina L.	Jonxha lupulinë
Medicago sativa L.	Jonxha
Medicago × varia T. Martyn	Jonxha hibride e ranishtave
Medicago falcata	Jonxha me frutë drapër (shumëvjeçare)
Medicago polymorpha	Jonxha zvarritëse
Onobrychis viciifolia Scop.	Sainfoin
Pisum sativum L. (partim)	Bizelja
Trifolium alexandrinum L. Berseem,	Tërfili aleksandrin
Trifolium hybridum L.	Tërfili hibrid
Trifolium incarnatum L.	Tërfili i kuqërremtë ose i purpurt
Trifolium pratense L.	Tërfili i kuq i livadheve
Trifolium repens L.	Tërfili i bardhë rrëshqanor
Trifolium resupinatum L.	Tërfili persian, i përmbystë
Trigonella foenum-graecum L.	Trëndelina
Vicia faba L. (partim)	Batha
Vicia pannonica Crantz	Grashina e Panonisë

Lathyrus sativa L.	Koçkulla
Vicia villosa Roth, Vicia ervilia	Grashina me qime, urovi
c) Other species	Specie të tjera
Brassica napus L. var. napobrassica (L.)	Sinapi
Brassica oleracea L. convar. acephala (DC.)	Lakra e zakonshme
Phacelia tanacetifolia Benth.	Kambanorja blu
Raphanus sativus L. var. oleiformis Pers.	Rrepat ose rrënjoret tuberoze foragjere

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 20.2.2013
Doli nga shtypi më 21.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 82 lekë